Rruga e Arbërit

Botim Periodik i Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Viti II i Botimit. **Nr. 2(10). Shkurt 2007** Çmimi: **30** lekë

Plasi edhe një tullumbace

Nga SHAQIR SKARRA

Zgjedhjet lokale përfunduan. Diku lanë një shije të hidhur nga ndonjë incident sporadik e diku tjetër iu gëzuan fitores së mirëpritur. Edhe premtimet e mëdha elektorale sikur u harruan njerzit pasi ato janë mësuar tashmë me të tilla tullumbace. Vetëm në qytetin e Peshkopisë njerzit ende jetojnë me këto premtime, megjithse dibranët nuk u besojnë shumë premtimeve elektorale. Kryeministri, zoti Sali Berisha, edhe njëherë në atë tubim të madh elektoral u shpreh pro Rrugës së Arbërit. Madje shkoi edhe më tej. U premtoi dibranëve se projekti i saj është më afër përfundimit. Që rruga e Arbërit po bëhet objekt i lakuar i të gjitha fushatave elektorale kjo duket. Kështu foli Berisha në vitin 2005, atëherë në opozitë. Kështu po në këtë vit foli dhe Nano, por bile ky shkoi dhe më tej. Në Bulqizë preu shiritin e fillimit të punimeve të rrugës së Arbërit në një segment të saj. U hap dhe pak trase, u shtruan dhe disa metra asfalt e projekti i kësaj rruge në fakt nuk kalon andej nga thoshte Nano në vitin 2005 por në krah të kundërt të saj. Në kohën që qeveria e zotit Berisha miratoi ligjin e koncesioneve u fol përsëri dhe rruga e Arbërit, bile nga vetë ministri i transporteve zoti Lulzim Basha por kjo u zhduk si flluska e sapunit. Nesër në mëngjez shtypi nuk e përmendi fare rrugën e Arbërit në listën e madhe të objekteve që do të jepeshin me koncesion nga qeveria shqiptare.

(Vijon në faqen 2)

RRUGA E ARBËRIT, rruga e zhvillimit të Shqipërisë lindore



Pamje e erozionit në gjipset e përroit të Gramës


Një vështrim perëndimor për Lurën

Nga Prof. Dr. SHABAN SINANI

Ndonëse e largët dhe e fshehtë, gati e pambërritshme, përveçse në përfytyrim, jo për shkak të thellësisë dhe lartësisë alpine ku gjëndet, si dhe vështirsive dhe rreziqeve të udhëtimit, por edhe për misteret e saj ende të pashfaqura, Lura historikisht ka qenë një vatër tërheqëse për mysafirë të shquar, vendas e të huaj, që ka ndezur fantazi nga më të çpenguarat. Figura të nderuara të arteve e të diturisë, misionarë të zbulimit të ekzotikës së këtij këndi të mënjantë të kontinentit europian, shtegtarë që i ka çuar rasti, gjeneralë, klerikë, shkencarë, turistë, investitorë, ekologë... *(Faqe 7)*

KADRI ROSHI PËR DIBRËN:

"Kur të flasësh për atë treve duhet ta lash gojën. Kur të flasësh për Dibrën, duhet të mendohesh mirë. Nuk do të më mjaftonte koha e gjithë roleve të mi, po të flisja, nuk do të më mjaftonte për të folur, vetëm për Dibrën. Ne, shqiptarët e vërtetë kemi mbetur pak, po s'ka gjë, shqiptarët e vërtetë janë dibranët, të madhes e të voglës. Gjeografinë e di mirë unë, por nuk harroj edhe historinë. S`di kush është e madhe dhe e vogël. Unë personalisht i jam mirënjohës, asaj treve, se më ka pritur, se të tërë shqiptarët dinë të presin mirë, por ja që mua më kanë pritur në një mënyrë të atillë, që nuk mund ta harroj dot. Më bënë miq me një të njohur, më bënë të dashur me një të njohur. U bëra shqiptar dhe më bënë shqiptar me një të njohur, unë këtë se harroj dhe për këtë u jam mirënjohës dhe s'kam se si, veç t'i falenderoj me fjalën më të bukur shqipe, iu faleminderit."



NË KËTË NUMËR:

Dibra e Madhe - Kosovë e Vogël - dhe Kosova plagë e saj
NGA **BEQIR SINA**
FAQE 10

Sali, hapi dy arteriet koronare të Shqipërisë
NGA ABDI BALETA
FAQE 8

Një Fjalor i Ri për Gjuhën Shqipe
Nga Prof. Dr. ENVER HYSA
FAQE 12

Ali Hoxha, veterani i gjurmëve të diturisë
Nga **MEVLUD BUCI**
FAQE 9

Safet Zhulali nderohet përsëri në Peshkopi
FAQE 2

Spitali i Peshkopisë, më i miri në gjithë zonën lindore
FAQE 3

Shuhet regjisori Gëzim Erëbara
FAQE 11

Bedri Hoxha, poeti i zërit mërgimtar
FAQE 9

Adresa e redaksisë: Blloku i banesave "Gintash", Laprakë. Tel.068 31 19 232. E-mail: Lid_gazeta@yahoo.com. www.dibra.org

Plasi edhe një tullumbace

(Vijon nga faqja 1)

Ato që e shpikën projektin e kësaj rruge nuk ishin as inxhinier e as projektues. I detyroi halli më shumë për të shkurtuar distancë por dhe për tu mbrojtur nga armiqtë. Nëpër këtë rrugë kaluan mbretër dhe perandorë, princër dhe gjeneralë, ushtarë dhe këmbësorë, karvane dhe taborre të mëdha. E si mund të vinte Skëndërbeu shkurt dhe pa u diktuar në ndihmë të Gurit të bardhë, Petrelës por dhe Krujës? Ishte pikërisht kjo rrugë aq e përfolur sot që ia krijonte këto mundësi. Sot kur pikërisht kjo rrugë u bë aq mediatike dhe e n johur të gjitha qeveritë e kanë lakuar .U lakua dhe kur doli ligji i koncesioneve dhe përsëri humbi. Shkurt, rruga e Arbërit deri tani ka qenë pre e tullumbaceve elektorale. Edhe mund t'u falet politikanëve pasi populli fal vazhdimisht por kjo nuk mund t'ju falet disa të quajturve intelektual dibranë që sot na thonë me bindje të plotë;

-Mosni se po bëheni si Don Kishoti me mullinjt e erës me këtë rrugën e Arbërit? Dhe kush. Disa pseudointelektual që ende punojnë në drejtorinë rrugëve.

U mjafton një rrogë dhe nuk duan as rrugë, as investime për Dibrën që i lindi i rriti dhe i arsimoi.Vaj halli kur flasin këto kur e quajnë veten për dibranë por të tjerët që nuk janë nga Dibra si do të thonë.? Ka dhe të tjerë që thonë se rruga e Arbërit nuk është kjo që flitet sot. Nejse le ti lëmë këto pseudointelektual në terezinë e tyre. Ttashmë rruga e Arbërit është futur në projektet qofshin dhe ato afatgjata të qeverisë shqiptare. Ajo një ditë do të bëhet se nuk është një projekt që i intereson Dibrës dhe dibranëve por është i vetmi projekt që lidh lindjen me perëndimin duke kaluar mes përmes Shqipërisë. Kjo rrugë është koridori i vetëm lindje - perëndim. Para pak ditësh u inaguruan fillimet e punimeve të tunelit të Kalimashit në rrugën e re Durrës-Prishtinë. Ky është një projekt i madh i qeverisë shqiptare dhe duhet realizuar sa më parë. Rruga e Arbërit ka gjithsejt tre tunele dhe që të tre nuk janë më shumë se pesë kilometra në një kohë që vetëm i Kalimashit është nëntë kilometra. Shumë veta shprehen se është një rrugë malore. Nuk dimë se ku e ka këtë përqindje kjo rrugë malore a vetëm një distancë prej treqind metrash por dhe kjo një malore më e vogël se Qafë Thana. Rruga e Arbërit është një rrugë me parametra bashkëkohorë ku kalon me një teren të bukur piktoresk që do ta kenë lakmi grupe turistësh të huaj.

Prefekti i Dibrës dashamirës i madh për investime në këtë zonë një ditë u shpreh:

-Që do të bëhet një herë rruga e Arbërit jam plotësisht i bindur. Kisha dëshirë ta realizonte kjo qeveri që unë po punoi. Edhe vetë dibranët janë të bindur që ky projekt madhor kaq i përfolur një ditë do të gjejë zbatim

Nuk është se kjo rrugë u shërben dibranëve por u shërben të gjithë shqiptarëve pasi ballkani qendror bashkohet shkurt me perëndimin. Shkupi shkurton plot 100 kilometra me Qafë Thanën. Po kështu dhe të gjithë shqiptarët e Maqedonisë, zonat e Matit dhe Bulqizës, Martaneshit dhe Gurit të bardhë, Xibrit të harruar dhe fshatit Fshat.

Ky projekt duhet të filloi sa më parë meqëllim që të mos u jap shkas politikanëve tanë të plasin tullumbace në takime elektorale. Boll më me të tilla premtime të dalë boje.tashmë ka ardhur tamam koha dhe momenti të kthejmë premtimet e dikurshme në vepra. Dhe një nga veprat që është premtuar më shumë vitet e fundit është rruga e Arbërit. Si dikur me karvane kur kaluan nëpër këtë trase dita po afron që do të kalojmë të gjithë me mjete, do të shijojmë bukuritë e natyrës shqiptare, do të shfrytëzohen pasuritë e shumta nëntoksore të Dibrës, Matit dhe Bulqizës, do të vijnë turistët nga të gjitha vendet e botës. Dhe atëherë e vetëm atëherë politikanët shqiptarë kanë të drejtë të mburren para elektoratit. Nuk do të jetë nevoja të plasin tullumbace por realizojnë vepra të mëdha siç është dhe rruga e Arbërit.

Sh. Skarra

Safet Zhulali nderohet përsëri në Peshkopi

Dibra dhe dibranët asnjëherë nuk i kanë harruar njerzit e saj, ato që kanë punuar një jetë për to. I tillë është dhe Safet Zhulali që dibranët nuk e harrojnë lehtë.Nuk janë vetëm përvjetorët ato që mblidhen për t'i kujtuar. Ka dhe mënyra të tjera. Ai lindi dhe u rrit në Peshkopi, në këtë qytet që e deshi dhe iu përkushtua gjithë jetës..Edhe kur u largua nga vendlindja Safet Zhulali asnjëherë nuk ia ktheu shpinën por vinte vazhdimisht dhe ishte i pranishëm në gëzime dhe hidhërime të qytetit të Peshkopisë. Lindi dhe mbeti një dibranë i mirë. Para pak kohësh këshilli bashkiak me vota unanime e nderoi figurën e Safet Zhulalit duke i dhënë titullin e lartë "qytetar nderi i Peshkopisë". Dhe jo vetëm kaq. Tani përsëri dibranët e përjetojnë ndryshe kujtimin e tij. Një rrugë kryesore në qytet mban emrin Safet Zhulali. Ky është një tjetër respekt që dibranët i bëjnë kësaj figure vërte të nderuar dhe respektuar në Dibër.

Xhami e re në Shumbat



Vetëm katër muaj më parë, katër të rinj nga fshati Shumbat u bënë inisiatorë për të ndërtuar në fshatin e tyre një xhami të re. Shumbati si një nga fshatrat më të mëdhenj në Dibër që nga viti 1967 kur objektet e kultit u bënë pre e vandalizmit të shtetit monist nuk ka patur më një xhami për besimtarët e vet. Banorët e këtij fshati herë faleshin në ndonjë shtëpi e herë shkonin larg në xhamitë më të afërta.

Ishin pikërisht të rinjt Sali Herra, Basri Kaza, Dashnor Skarra e Besnik Skarra të cilët si emigrant që ishin kontribuan të parët për të ndërtuar xhaminë në fshatin e tyre. Për ndërtimin e këtij objekti ndihmuan dhe vetë fshatarët. Dikush me para e dikush solli dyer e dritare, dikush çimento e të tjerë ndanë punën deri sa përfundoi objekti. Vetë fshatarët e Shumbatit përmendin edhe Xhevahir Bahitin antar i Përgjithshëm Komitetit Musliman Shqiptar nga Librazhdi e Rruzhdi Hoxha nga Tomini të cilët edhe këto bashkë me shumbatasit dhanë kontribut në lek dhe dhurata të tjera për ndërtimin dhe kompletimin e xhamisë. Komisioni i ngritur posaçërisht për ndjekjen e punimeve ishin Kasam Skarra, Sherif Herra e Ali Mema. Më datën 29 dhjetor 2006, një ditë para Kurban Bajramit xhamia e re hapi dyert për besimtarët shumbatas. Ajo u mbush plot përplot me mosha të ndryshme. Jo vetëm të moshuarit por dhe të rinjt u bënë vizitorë të xhamisë dhe kështu mbetën gjithmonë. Në inagurimin e xhamisë kishin ardhur Ahmet Çaushi nga Peshkopia dhe Xhevahir Bahiti nga Librazhdi të dy antar të Këshillit të Përgjithshëm të KMSH si dhe Muhamet Shehu antar i këshillit të Myftinisë Dibër. Aktiviteti i kësaj ditë feste u mbyll me një dua dhe angazhim të të gjithve që ta bëjnë xhaminë vend adhurimi për Zotin, vend bashkimi e dashurie për njëri tjetrin, vend për të mësuar sa më shumë e për ta bërë jetën të qetë e të begatë në trojet e vjetra.

MUIZ KËRTULLA
antar i këshillit të Myftynisë Dibër

Spitali i Peshkopisë më i miri në të gjithë zonën lindore

Falë investimeve dhe donatorëve të huaj sot spitali i Peshkopisë është një ndër spitalet më të mirë dhe kompletuar në të gjithë zonën lindore. Kjo nuk duket vetëm nga jashtë nga godinat e bukura por dhe mjediset përreth . Brenda bindin këdo se kemi të bëjmë vërtet me një spital model. Edhe vetë personeli i spitalit duke patur këto mjedise pune, duke punuar në një spital që do ta kishin lakmi majft koleg të tyre në qytete të kategorisë së parë e kanë vënë veten gjithmonë në shërbim të të sëmurit. Këtu nuk ka ndodhur që medikamentet të blihen nga vetë të sëmurët. Një i moshuar nga Luznia i cili ishte i shtruar shprehet;

-Qoftë dhe një aspirinë e vetme nuk na mungon këtu. Edhe kushtet janë shumë të mira.Ja kemi ngrohje pasi kaldajat punojnë në çdo kohë.Kjo ngrohje në këto dit të ftohta mund të na mungojë dhe në shtëpitë tona. Kemi batanie të reja gjë që i mungojnë edhe Tiranës. Fakt është se këtu punohet.

-Punojnë të gjithë, thotë drejtori i spitalit Ardian Bitri, një kirurg duar artë siç shprehen dibranët.

Sot për sot i kemi këto kushte të mira nda na takon ne që ti mirëmbajmë.Vërtet pavioni i kirurgjisë model nga të gjitha, nga paisjet, nga sallat operatore, nga reanimacioni, nga kultura e lartë e shërbimit, nga pastërtia, nga ashensori i cili ishte në gadishmëri të plotë.Shkurt këtu në spitalin e Peshkopisë humanizmi ende ekziston, ndoshta jo në ato principe si më parë por ama mjeku nuk shikon xhepat por të sëmurin. Pavioni i kirurgjisë mban emrin e njërit ndër pionierët e kirurgjisë në Dibër Irfan Jashari. Edhe këshilli bashkiak i qytet e ka shpallur qytetar nderi Irfan Jasharin..

-I kemi vënë vetes detyrë thotë mjekja kardiologe Zana Lleshi që spitalin tonë ta kthejmë në një spital model në të gjithë vendin dhe mundësitë i kemi. Më shumë punë duhet bërë për kardiologjinë pasi këtu ende na mungojnë aparaturat e nevojshme. Ashtu sikur bëhen dhe ndërhyrje të vështira kirurgjikale përse të mos kemi mundësi që dhe analizat e zemrës t'i bëjmë të gjitha në Peshkopi meqëllim që të sëmurët të mos sorollaten nga Tirana me dit të tëra. E mundësitë janë, personelin e kemi. Mjafton pak paisje bashkëkohore dhe vetëm kaq

Nëpër të gjithë pavionet pastëri dhe rregull, ngrohje në këto dit të ftohta dimri dhe humanizëm nga bluzat e bardha. Ashtu si kirurgjia është dhe materniteti apo pediatria. Shkurt këtu është investuar por dhe punohet. Punohet me përkushtim ku i gjithë personeli është kthyer në shërbim të sëmurit dhe në ruajtje dhe përkujdesje të spitalit. Ndaj dhe spitali i Peshkopisë është vlersuar si një ndër spitalet më të mirë në të gjithë zonën verilindore.

KËSHILLI BOTUES I GAZETËS

Drejtor: **RAKIP SULI**
Kryeredaktor: **SHAQIR SKARRA**
Redaksia: **Hajri Mandri, Prof. Dr. Bashkim Lleshi, Bujar Karoshi, Dukagjin Hata, Dr. Hasan Leka, Mirvet Lala**
ADRESA E GAZETËS: Blloku i banesave "Gintash", Laprakë.
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179.
Email: lid_gazeta@yahoo.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin qëndrimin e Redaksisë dhe Shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë".

Shoqata "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" ka dhe numrin e saj të llogarisë në **PROCREDIT BANK**
Në lek 13-661344-0001 . Euro 13-661344-0102 . USD 13-661344-0203


NJOFTIM

Gazeta "Rruga e Arbërit", njofton të gjithë lexuesit dhe bashkëpunëtorët, se numri i radhës së gazetës do të dalë çdo të diel të fundit të muajit. Për abonimet dhe shpërndarjen e gazetës në adresën tuaj, duhet të telefononi në numrin e telefonit: **(04) 357 179** ose të na shkruani në **E-mail: lid_gazeta@yahoo.com**

RRUGA E ARBËRIT,

rruga e zhvillimit të Shqipërisë lindore

Pasuritë dhe problemet



Nga
VESEL HOXHA*

Që në fillim të këtij shkrimi “pak të hallakatur” dua të bëj me dije lexuesin se, në kuadrin e ekonomisë së tregut brenda vendit apo dhe në kuadër të asaj europiane e globale ku tentojmë të integrohemi, kam mendimin se infrastruktura rrugore, në rastin konkret Rruga e Arbërit ka ndikim përcaktues nëse një pasuri minerale (apo e një natyre tjetër) që gjendet në Shqipërinë Lindore mund të shfrytëzohet për të përballuar nevojat e tregut ku aspirojmë, ose e thënë me fjalë të tjera kjo pasuri do të shfrytëzohet për të mirën e krahinës e të Shqipërisë apo do të vazhdojë të flejë në nëntokën apo mbitokën tonë**, siç ka fjetur në milionat e saj që nga koha e formimit**. Me termin Shqipëri lindore nuk kam parasysh vetëm rrethet kufitare me Maqedoninë, si Dibrën, Bulqizën etj., që do të përfitojnë drejtpërdrejt nga ndërtimi i kësaj rruge por, dhe të ashtuquajturën nga ana e shtetit maqedon si Maqedoni Perëndimore, që në fakt, as më shumë e as më pak është Shqipëri Lindore, emërtim ky i përdorur rëndom e me të drejtë në faqet e gazetës “Rimëkëmbja” nga **i madhi profesor Baleta.** Më pëlqen që në hyrje të citoj edhe disa rreshta, nga shkrimi **“Skënderbeu dhe Skavica”** i z. Bujar Karoshi, botuar në numrin **9** të gazetës “Rruga e Arbërit”, të cilat i kam shkëputur në frazën e parafundit : “… të nxisë donatorët vendas e të huaj, të mbështesin **frutikulturën e** bujqësinë në tërësi, të nxisin investimet **në tokën e nëntokën ……**që Dibranët të qëndrojnë në **tokën e tyre, në vendin e tyre**, të investojnë e zhvillojnë **Dibrën……..”.**

PASURITË MINERALE METALORE E JO METALORE

Në rrethin e Dibrës, siç kam trajtuar dhe në shkrime të tjera të mëparshme të botuara në revista apo gazeta të ndryshme, takohen shumë shfaqje të mineraleve të dobishme, ku mund të përmendim si metalore**: xeheroret e kromit, hekurit oksid e silikat, hekur - nikelit, bakrit, arsenik – polimetaleve, manganit, vanadit, aluminit (boksideve), platinit e sulfureve te nikelit, oreollave të arit etj. dhe nga** jo metalorët mund të **veçojmë mermeret, gëlqerorët e mermerizuar, argjilat, travertinat, squfurin, bojërat e dheut, gjipset, anhidritet, selenitet, inertet, gëlqerorët, dunitet, peridotitet, azbestin, gurin e talkut, pirofilitet, kuarcitet, granitet, shapet e Na-K, grafitet, rreshpet metamorfike etj.**

Për sa më sipër, për një pjesë të shfaqjeve të sipërpërmendura, bazuar në studimet e punimet e kryera ndër vite, mund të thuhet se janë vendburime, kurse për një pjesë tjetër, me punime shtesë gjeologo-zbuluese, në raste të veçanta dhe komplekse gjeologo-gjeofizike-gjeokimike, shpresohet se mund të konkretizohen vendburime të dobishme.

Alabaster (**gjipsi kristalin me ngjyrë të bardhë e pamje sheqerore**) në kuptimin e mirëfilltë mineralogjik, takohet shumë rrallë dhe në formë dejesh e damarësh me përmasa të papërfillshme për nivelin e sotëm të njohjes. Për arsye nga më të ndryshmet, në literaturën e shkruar në vendin tonë përmendet sikur në rrethin e Dibrës gjenden miliona ton alabaster, çka ka krijuar **një pështjellim** të gabuar rreth këtij problemi. Do të ishte me shumë leverdi sikur edhe ky lloj gjipsi (për fat të keq në gjuhën e përditshme shqiptohet gips) të takohej në sasi e cilësi edhe në **masivin gjipsor të Dibrës**, ashtu siç takohet në **zonën e Kavajës** etj., ndonëse dhe atje jo në atë cilësi që kërkohet në tregun e tij.

Studimet flasin se rrethit të Dibrës nuk i mungojnë as mineralizimet radioaktive, të rrallët e të çmuarit si dhe ka premisa për naftë e gazmbajtje, të mbështetura në studime tematike e regjionale të kryera nga institucione e specialistë të afirmuar të vendit tonë.

Një perspektivë të qartë për mundësi futje në qarkullim ekonomik kanë **gjipset, anhidritet, selenitet, argjilat, mermeret dhe gëlqeroret e mermerizuar, granitet, travertinat** etj., pasuri që natyra nuk i ka kursyer. Një pjesë e madhe e mineraleve jo metalore me shumë pak punime mund të futen në qarkullim ekonomik, kurse disa prej mineraleve metalor, me punime e studime shtesë nga firma private vendase e të huaja, mund t’u rriten rezervat dhe t’u çelet perspektiva për të filluar shfrytëzimi i tyre, si në Selishtë, Lurë, Korab etj.

Studimet flasin se rrethit të Dibrës nuk i mungojnë as mineralizimet radioaktive, të rrallët e të çmuarit si dhe ka premisa për naftë e gazmbajtje, të mbështetura në studime tematike e regjionale të kryera nga institucione e specialistë të afirmuar të vendit tonë.

Jo vetëm miniera e **mermerit në Muhurr**, që për habinë e të gjithëve ka ngelur në atë gjendje as mish e as peshk dhe për të cilën duhet të lëvizin organizmat shtetërore përgjegjëse e ato private të interesuara, **është imperative të fillojë sa më parë nga puna** dhe, po ashtu mund të thuhet edhe për shumë shfaqje të tjera që takohen në Arras, Reç, Korab, etj.

Nisur nga rritja e çmimit të mineralit të **kromit** në tregun botëror, firma private vendase dhe të huaja do ta rrisin interesimin për shumë vendburime, qofshin dhe të vogla të zbuluara nga gjeologjia ndër vite në masivin e Bulqizës (zona e Selishtës), Lurës, për t’i shfrytëzuar. Po kështu mund të vazhdohet edhe për minerale të tjera metalore e jo metalore, ku nënvizojmë industrializimin e evaporiteve, argjilave të gropës së Peshkopisë, travertinave etj., ku këta të fundit mund të shfrytëzohen si gurë dekorativë me vlera të pazëvendësueshme si për nevojat lokale, ashtu dhe jashtë rrethit, gjë për të cilën flet dhe fakti i interesimit të madh për to kohët e fundit, veçanërisht për ato të zonës **Vleshë–Dipjakë**.


Unë do të nënvizoja se me hapjen e Rrugës së Arbërit mundësi futje në qarkullim ekonomik do të kenë më shumë mineralet jo metalore, kjo ndoshta edhe për disa arsye që do të përpiqem të rendis më poshtë, mendime të cilat janë të konsultuara edhe me ish pedagogun e autorin e librit të gjeologjisë së vendburimeve të mineraleve të dobishme jo metalore, me profesorin e nderuar me origjine dibrane nga krahina ime e Çidhnës, zotëri Agim Tërshanën.

Në shumë vende të botës, **sidomos në ato të industrializuara**, vihet re një epërsi në nxjerrjen e mineraleve jo metalore ndaj atyre metalore. Vetë zhvillimi i kësaj dege të gjeologjisë, si dhe i teknologjisë, lidhet ngushtë me zhvillimin e përgjithshëm shoqëror, ekonomik e industrial të çdo shteti apo **rajoni në veçanti**.

Ndër shkaqet kryesore që e bëjnë fushën e kërkimit, të nxjerrjes e të përpunimit të lëndëve të para jo metalore, të zërë një vend të dukshëm në ekonominë e çdo shteti të përparuar janë: mungesa e **metalit dhe nevoja e zëvendësimit** të tij; zbatimi i **metodave kimike** të përpunimit të lëndëve të para jo metalore; arritjet e mëdha në **fushën e pasurimit** e të teknologjisë së tyre; shtimi së tepërmi i nevojave të bujqësisë **për plehrat minerale**; rritja me ritme të shpejta e **ndërtimeve industriale** dhe civile; zhvillimi i **teknikës bërthamore reaktive; satelitëve** etj...



Pamje e dukurive karstike mbi shkëmbinj karbonatik.



Burim uji në Gjiset e përroit të Llixhave

Sot ka kërkesa të shumta për materiale **zjarrduruese**, lëndë të **lehta ndërtimi** etj., që synojnë të zëvendësojnë prodhimet metalore me ato **qeramike, plastike** e të përziera. Në tërësi shpenzimet për vënien në përdorim të mineraleve jo metalore janë më të vogla dhe sjellin më pak probleme të karakterit metalurgjik e të ruajtjes së mjedisit.

Organizimi i punës për vlerësimin e përdorimin e rezervave minerale jo metalore synon drejt një studimi dhe trajtimi ndërdisiplinor. Qarku i kërkimeve ndërdisiplinore konceptohet në këtë mënyrë: **Në krye qëndron gjeologjia** që përcakton vendburimet, vijon **inxhinieria minerare** që përcakton mënyrën e shfrytëzimit dhe koston e nxjerrjes, më pas vjen **trajtimi teknologjik** për gjetjen e mënyrave më efektive të punimit e të përpunimit të mineralit, vijon **inxhinieria kimike** e cila merret me përpunimin e prodhimeve për kërkesat e industrisë, ku me këtë të fundit lidhet ngushtë **sektori i kërkimeve shkencore,** i cili studion fushat ku mund të përdoret lënda apo lëndët e para dhe drejtimet e tjera të reja të mundshme të përdorimit, vijon **sektori i tregtisë** i cili gërsheton mendimin teknik me atë ekonomik, përcakton çmimet dhe vendet për eksport, madhësinë e prodhimit etj.

Me sa shtjelluam më sipër për lexuesin deshëm të sqaronim **kalvarin e punëve** për t’u futur në qarkullim ekonomik **minerali i dobishëm** dhe, më së fundmi e gjithë kjo punë merr frymëmarrje të **thelle, kur infrastruktura është efektive siç shpresohet në ndërtimin e Rrugës së Arbërit, rrugë e cila do të afrojë investitorët me mineralin.**

Rrethi i Dibrës është i pasur me **minerale industriale,** ku veçojmë

(Vijon në faqen 4)

**Autori i shkrimit është Doktor i Shkencave Gjeologjike, punonjës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, Tiranë.*

RRUGA E ARBËRIT,



Pamje e Liqenit të Luleve - Lurë.

Me hapjen e Rrugës së Arbërit, ujërat e freskëta, cilësore e me debite të kënaqshme të Dibrës do të jenë në tavolinat e shumë shqiptarëve, me çmime shumë më konkurruese, me emërtesat e Korabit, Lurës, Setës, Runjës, Ilnicës, Selishtës, Bjeshkës së Zonjave etj.

(Vijon nga faqja 3)

azbestin, pirofilitin, olivinitet, ultrabaziket e serpentinizuar etj.; **me minerale si lëndë të parë teknike,** ku veçojmë argjilat, kuarcitet, shkëmbinjtë silicorë, shkëmbinjtë karbonatikë, gjipsin, anhidritin etj.; **me minerale si lëndë e parë kimike,** ku mund të përmendim squfurin, kripërat minerale, bojërat e dheut etj.; **me minerale si lëndë e parë për materiale ndërtimi,** ku mund të veçojmë rërat, zhavorret, gurët e ndërtimit, gurët veshës dekorativë, shkëmbinjtë mbulues me karakter pllakor, shkëmbinjtë për petrorurgji (bazaltet- diabazet, andezito- bazaltet etj.).

PASURITË UJORE, NDËR MINERALET E ÇMUARA QË KA RRETHI I DIBRËS

Dibra ka shumë pasuri ujore për sot e për brezat që kërkojnë një vlerësim e menaxhim të mirë e kompleks në tërë kuptimin e kësaj fjale.

Në afërsi të qytetit të Peshkopisë ndodhen burimet e ujërave termo-minerale sulfi-hidrike, të njohura me emrin "Llixhat e Peshkopisë" ose "Banjat" siç i thërret populli ynë, me vlera të pallogaritshme kurative, turistike, për rritjen e luleve, të disa llojeve të peshkut, për ngrohje etj. Rruga e Arbërit do t'i afrojë ato me metropolin shqiptar në 2 orë udhëtim.

Në gjendjen aktuale të ndodhjes së tyre nuk mund të flitet për vlerësim të kësaj pasurie natyrore.

Mendoj se duhen gjetur forma e metoda të tjera, sigurisht të mbështetura me investime, për ta shndërruar këtë pasuri në dobiprurëse të madhe për ekonominë e rrethit. Përfundimi i Rrugës së Arbërit duhet të na gjejë të përgatitur, pasi fluksi i të interesuarve nuk do të jetë ky i tanishmi për drejtimet që parashtruam më lart dhe projektet duhet të nisin, sa nuk do të jetë vonë. Kjo pasuri kërkon më shumë vëmendje, projekte, studime e ndërtime të shumëllojshme në shërbim të saj që, ajo të na e kthejë në të mirën e zhvillimit të mëtejshëm të zonës, kryesisht bashkisë së Peshkopisë.

Rrethi i Dibrës gjithashtu është i pasur me shumë burime ujore të freskëta (mbi 40 burime me debite që variojnë nga 5 – 10 - 300 l/sek. e, ne disa raste maksimumi i debitit i kalon 300 l/sek..), të cilët lidhen me shkëmbinjtë sedimentarë, kryesisht të përbërjes karbonatike (karstike etj.), magmatike, metamorfike etj., ashtu dhe me ujëra nëntokësore që lidhen me formimet e neogjen - kuaternarit, kryesisht rreth luginës së Lumit Drini i Zi, e ashtuquajtur ndryshe si "Gropa e Peshkopisë", në terracat e tij, konuset e përrenjve etj., etj...

Burimet e freskëta të Bjeshkës së Preshit (kryesisht Stanet e Preshit, ku aktualisht merret një sasi e ujit që furnizon qytetin e Peshkopisë dhe disa fshatra përreth linjës ku kalon tubacioni kryesor i ujësjellësit), Bjeshkës së Gramës që furnizojnë liqenin me të njëjtin emër, Bjeshkës së Shehut etj., përbëjnë **drejtimin kryesor të përmirësimit** të furnizimit me ujë të freskët, cilësor e me vetërrjedhje të tyre.

Drejtim tjetër po aq i rëndësishëm janë burimet e anës perëndimore të rrethit, ku përmendim ato të Sopanikës së Lurës në afërsi të Gur - Lurës , në krahun e djathtë të rrjedhjes të përroit të Setës ose e thënë ndryshe, përballë burimit të Xhaxhait, ku aktualisht merr ujë fshati Çidhën e Poshtme, (ndonëse një ujësjellës "halli" kur i thonë në gjuhën popullore); mundësitë e takimit **të ujërave karstike të Klogjneshës në kuota më të larta** (duke u ndihmuar nga punime komplekse gjeologo-gjeofizike) mbi fshatin Çidhën e Poshtme, burim i cili furnizohet nga zona e majës së Kumbullës në malin e Faqes dhe malit të Xharxhishtit etj., janë disa **nga burimet ujore kryesore** nga ku mund të mbështetet furnizimi me ujë të pijshëm, të freskët e me vetërrjedhje i fshatrave të luginës së lumit Drini i Zi, për sot e në perspektivë, e pse jo edhe i qytetit të Peshkopisë.

Burimi i Izvirit ndodhet mbi fshatin **Tejas** në Komunën e Kalasë së Dodës, ku merret pjesa tjetër e ujit që furnizon qytetin e Peshkopisë dhe fshatrat përreth. Në disa punime shkencore të kohëve të fundit të kryera nga ish Dega Rajonale Gjeologjike e **Peshkopisë nuk rekomandohet të shfrytëzohet gjatë gjithë vitit,** por vetëm në periudhën e dimrit, kur territori mbi burim është i mbuluar nga dëbora etj., specifika që rekomandojnë studimet e specializuara gjeologo-hidrogjeologjike, kjo për faktin e thjeshtë se **ekziston mundësia e kontaminimit (infektimit) të ujërave në fjalë** në zonën e Fushës së Panairit dhe Rrafshit të Korabit, nga ku furnizohen e qarkullojnë ujërat e burimit të Izvirit (Izvorit).

Do të duhen dhjetëra vite e ndoshta më shumë, kur këto mundësi furnizimi që trajtuam më sipër do të jenë jo të mjaftueshme për banorët e këtyre trevave, aq më tepër, po të kemi parasysh dhe lëvizjet drejt zonave më të populluara, në aksin Tiranë – Durrës apo në ultësirën pranë - adriatike.

Ndoshta nuk është vendi, por e shikojmë të arsyeshme **të ndriçojmë dhe një fakt** që lidhet me investimin për furnizimin e qytetit të Peshkopisë me ujë të pijshëm 24 orë, një investim ky që për nga vlera është për t'u përshëndetur.

Mundësitë e furnizimit me ujë të pijshëm nga terracat e luginës së lumit Drini i Zi në kushtet aktuale, mendojmë se jo vetëm nuk do ta zgjidhin problemin në cilësi dhe sasi, por do të krijojnë probleme të vazhdueshme e komplekse, e lidhur kjo edhe me mundësitë e kufizuara të furnizimit me energji elektrike dhe pasojat në koston e lartë për konsumatorët.

Edhe rruga tjetër e furnizimit me ujë nga shpimet nëntokësore të hapura në formimet aluviale të lumit Drini i Zi, që është aplikuar e po përfundon, **konsiderohet një zgjidhje** por, e pabazuar në studimet gjeologjike e hidrogjeologjike të kryera ndër vite nga shërbimi gjeologjik i rrethit të Dibrës, si njësi e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar. Firma private që ka ndërmarrë studimin **(ndonëse për të kryer shpime në shtratin e lumit nuk ka nevojë për studime të kushtueshme, për shumë arsye)** nuk e ka zgjidhur plotësisht problemin, falë dhe faktit se janë kryer pa oponencën e Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, **detyrimin ligjor për të gjitha subjektet që shpojnë në thellësi të tokës nën 15 m për kërkimin e ujërave, oponencë e cila e vënë para detyrimeve shtetërore për të garantuar sasinë e cilësinë e ujit për popullatën nga rrjeti i puseve të shpimit, duke ruajtur parametrat dhe regjimin e ujërave nëntokësore.**

Tani le të dalim tek rëndësia e Rrugës së Arbërit dhe ndikimin që ka ajo në këtë fushë. Që në fillim do të nënvizoja rëndësinë e madhe që kanë ujërat e pijshëm të trevës së Dibrës për t'u industrializuar, për të konkurruar e sfiduar shumë burime të tjera që me aq zhurmë e bujë orë e çast mbushin me reklama ekranet televizive në vendin tonë. Me hapjen e kësaj rruge edhe ujërat e freskëta, cilësore e me debite të kënaqshme të saj do të jenë në tavolinat e shumë shqiptarëve, me çmime shumë më konkurruese, me emërtesat e Korabit, Lurës, Setës, Runjës, Ilnicës, Selishtës, Bjeshkës së Zonjave etj. etj. Nuk janë të rastit që në shumë vende të trevës së Dibrës gjenden me shumicë emërtime **si kroi i Mbretit** etj., dukuri sipas nesh që nuk lidhen me faktin se aty ka kaluar dhe ka pirë uji mbreti apo variante të tjera të interpretimit sipas tregimeve gojore popullore por, me cilësinë e ujërave të Dibrës që, pak ose fare pak u është bërë reklamë, pa hyrë pastaj në rrugët e komercializimit të këtyre burimeve. Ujërat që lidhen me shkëmbinjtë karbonatikë, kryesisht ato të pjesës lindore, janë të një cilësie shumë më të mirë se shumë ujëra në vendin tonë, për faktin e thjeshtë se këto formacione janë të metamorfizuara (gëlqerorë të mermerizuar deri mermerë), për pasojë dhe tretja e tyre nga qarkullimi i ujërave nëpër hapësirat karstike ndodh në përqindje të vogël, duke mos lejuar shtimin jashtë normave të elementeve që përcaktojnë cilësinë dhe shijen e tij, si të **kalciumit, magnezit, natriumit** etj.

Këtu e gjeje me vend të përmend fjalën e urtë popullore që thotë: **"Është lirë krypa në Durrës, por e ha qeraja rrugës"**. Ndërtimi i Rrugës së Arbërit do ta pakësojë qeranë dhe do të hapë drejtime të reja aktivitetesh prodhuese me leverdishmëri dhe efektivitet në këtë drejtim.

PASURITË TURISTIKE E GJEOTURISTIKE

Studimet flasin se rrethi i Dibrës ka vlera të mëdha turistike e gjeoturistike, të cilat jo vetëm janë të shumta, por dhe me vlera të pallogaritshme për ekonominë e trevave ku ato ndodhen, ku mund të përmendim peisazhet e **dukurive erozionale të evaporiteve** (gjipseve, anhidriteve etj.,) në përruan e Gramës etj.; liqenet kryesisht akullnajorë të Lurës **(gjithsejt 13, të na falin ato që janë mësuar me numrin shtatë, ndoshta "kënga e ka dashur" që të jenë shtatë)**; të Selishtës (**gjithsejt 40**); të Korabit (**gjithsejt 10**); fushën e Rrafshit të Korabit; Fushën e Panaireve, e cila e vrojtuar nga maja e Korabit **2764 m** lartësi mbi nivelin e detit të mahnit me bukuritë e saj; Bjeshkët e Malësisë së Korabit **(në pikpamje gjeografike janë të vendosura në të dy anët e kufirit shqiptaro - maqedon ose e thënë ndryshe, midis kufirit të Shqipërisë londineze dhe Shqipërisë lindore),** ku përmendim atë të Preshit, të Shehut, të Abazit, të Gramës etj.; Lanën e Lurës; prerjet e formimeve paleozoike në zonën e Muhurrit me të famshmet graptolite (fosile) etj.

Në takimin që kam patur këto ditët e fundit me profesorin e nderuar **Afat Serjani**, më ka bërë përshtypje të madhe dhe njëkohësisht më ka inkurajuar fakti se sa me pasion flet ky njeri për gjeomonumentet e Dibrës, duke insistuar që të ndërmerret një projekt i detajuar për mundësitë e studimit dhe evidentimit të vlerave gjeoturistike të saj. **Prof. Afati nuk është dibran**, është



Pamje e pjesshme e Rrafshit të Korabit.

rruga e zhvillimit të Shqipërisë lindore

nga **Gjirokastra**, por dijet e tij shkencore dhe pasioni në këtë lëmë, edhe pse është në pension, e ngacmojnë dhe e shtyjnë që ky merak të mos ngelet brenda tij, por të marrë rrugë institucionale, ku vlerat gjeoturistike të trevës së Dibrës të njihen, të propagandohen duke u bërë shkak për të tërhequr vëmendjen e turistëve apo vizitorëve vendas e të huaj, qoftë dhe me ndërtimin fillimisht të një fletëpalosje, e cila do t'u bëjë të njohur të interesuarve këto pasuri.

Më lejoni të tregoj një episod që ka lidhje pikërisht me këto vlera që ne pak i njohim, pak i propagandojmë, pak punojmë e investojmë për to, pak kujdesemi për t'i ruajtur nga dëmtimet, të mos themi se në shumë raste i kemi nënvleftësuar, duke mos e kuptuar rëndësinë që kanë për sot e në perspektivë, për ne e për brezat, e në raste të tjera duhet të na e thotë ndonjë i "huaj" që të vihemi në lëvizje në drejtimin e duhur.


Pamje e Liqenit të Gramës

Studimet flasin se rrethi i Dibrës ka vlera të mëdha turistike e gjeoturistike, të cilat jo vetëm janë të shumta, por dhe me vlera të pallogaritshme për ekonominë e trevave ku ato ndodhen, ku mund të përmendim peisazhet e dukurive erozionale të evaporiteve në përruan e Gramës, liqenet kryesisht akullnajorë të Lurës, të Selishtës, të Korabit, fushën e Rrafshit të Korabit; Fushën e Panaireve, Bjeshkët e Malësisë së Korabit, Lanën e Lurës; prerjet e formimeve paleozoike në zonën e Muhurrit, e shume të tjera

Intermexo për kureshtarë

"Në verën e vitit **1988,** më ka rastisur të shoqëroj për probleme pune në malësinë e Korabit, njërin nga profesorët më të nderuar të Francës në fushën e gjeoshkencave, **Pierre Vergely.**

Sapo arritëm në majën më të lartë të vendit tonë, në lartësinë 2764 m, ku ndryshe thirret dhe Piramida Nr.4 **(në librat shkollorë nuk e përmend njeri këtë lartësi, por janë fiksuar në shifrën 2751 m, ndonëse të dhënat e matjeve të fundit lëvizin në shifrat 2754, 2757, 2763 e 2764 m, madje po the ndonjë shifër tjetër mësuesja e gjeografisë që se ka parë dhe në ëndërr Korabin, të ul menjëherë notën sikur ke bërë ndonjë hata**), para se të fillonim nga puna për të cilën kishim ardhur, pas gjithë asaj lodhje të madhe, profesori francez që cituam më sipër, pasi ledhatoi ngadalë mjekrën e tij laramane e të gjatë me dorën e djathtë, u mbush thellë me frymë, bëri një psherëtimë të thellë e ju drejtua **profesorëve Alaudin Kodra e Kadri Gjata**, dy prej shkencëtarëve të gjeologjisë shqiptare që bënin pjesë në grupin tonë të vrojtimeve fushore, duke ju thënë**: "Sikur të ishte me ne këtu presidenti i vendit tim, do të firmoste një çek për të ndërtuar këtu një fushë hipizmi…….. etj.",** (bëhej fjalë për **fushën e Panairit** që, nga vendasit thirret edhe me emrin **"Punajër**" (të na falë **Dr.Gjabri,** pasi fusha e Panairit nuk është pjesë e rrafshit të Korabit dhe emërtimi popullor nuk është **"punair"**), e cila shpalos një pamje mahnitëse e parë nga kjo lartësi). Sigurisht, profesori nuk ishte ekspert për këto probleme e, ndoshta e tha edhe për humor, por ne shqiptarët kemi një proverb se: "Shakaja është gjysma e së vërtetës", falë faktit të kënaqësisë e befasisë që të japin ato vise, aq më tepër kur i shikon për herë të parë, që me të drejtë janë quajtur nga **profesor Serjani**, amfiteatri malor i Korabit.

Shumë vite më vonë, në verën e vitit 1995, përsëri më ka takuar rasti të shoqëroj po në majën e Korabit, pra në Piramidën Nr.4, specialistët e shquar gjermanë në fushën e paleontologjisë**, Prof. Peter Koenigskof dhe Dr. Eberhardt Schindler** së bashku me pedagogun e Gjeologjisë Historike e të Paleontologjisë në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave, mikun tim **Prof. Selam Meçon**, të cilët po ashtu shprehën kënaqësinë e tyre për këto bukuri përrallore, që justifikojnë çdo investim për turizëm malor veror e dimëror, pasi sjellin shumë fitime për krahinën e kënaqësi për vizitorët. Për të qenë më i saktë me lexuesin, ata shprehën idenë e ndërtimit të një teleferiku, i cili do të realizonte njëherësh shumë funksione, ku në plan të parë do të ishte pa dyshim turizmi malor, për të shijuar bukuritë e pafund të këtyre anëve, **që janë të rralla në Europë dhe në botë.**

Për kënaqësinë e lexuesit, të dhënat paleontologjike flasin se mosha e gëlqerorëve që ndërtojnë majën e Korabit, majën më të lartë në vendin tonë, është e Devonianit të mesëm, e thënë ndryshe këto shkëmbinj janë formuar në detin e Devonianit para 375 milion vjetësh."

Monumentet e gjeomonumentet e natyrës duhen parë si një fushë me rëndësi për turizmin aq të dëshiruar nga të gjithë, por që, në praktikë, bëjmë pak për të mos thënë aspak, kur vjen puna për investime konkrete, duke ngelur në rrafshin e dëshirave e të konstatimeve, duke mos lëvizur asnjë gur, siç thuhet rëndom.

Ndër gjeomonumentet me vlera të jashtëzakonshme (regjionale-ballkanike dhe europiane) mund të përmendim **vendburimin e kromit të Bulqizës**, një vendburim unik për nga përmasat, rrudhosjet, prerjet e shkëmbinjve me të cilat lidhet minerali aq i njohur i kromit, vetë lugina e madhe e Vajkalit etj. Në vendburimin e Bulqizës duhen ruajtur nivele të veçanta, të hapura për shfrytëzimin e kromit, për brezat e ardhshëm, përpara se të jemi vonë kur kjo do të jetë imperative.

Vendburimi kristalor i gjipsit të Radikës që njihet me emrin mineralogjik seleni, në afërsi të qytetit të Dibrës, në anën e djathtë të rrjedhjes së lumit Radika ose buzë liqenit të sotëm të krijuar nga diga e ndërtuar në afërsi të Lladomericës, në ish republikën jugosllave të Maqedonisë, një vendburim i rrallë, unik në llojin e vet, ku duhen ruajtur hapësirat e mëdha të shfrytëzimit nëntokësor me gjithë ansamblin kristalor të përsosur, vezullues e mahnitës që i mbështjell ato, pa përmendur dhe një sërë gjeomonumentesh të tjerë në këtë vend; **Kupola brahiantiklinale e evaporiteve** (gjipseve dhe anhidriteve) që njihet nga vendasit masivi gjipsor i Malit të Bardhë, midis fshatit Radomirë në veri (lagjet Rade dhe Stredok) dhe përroit të Gramës në jug, me përmasa 10 x 3 km; prerjet e formimeve stratotipe **paleozoike me graptolite në zonën e Muhurrit** dhe një sërë gjeomonumentesh natyrore të tjera të kësaj rëndësie që, për fat të keq, jo vetëm nuk njihen nga popullata vendase, por as nuk janë propaganduar nga segmente të ndryshme shtetërore apo shoqata që, në një formë apo në një tjetër, kanë shpenzuar lekët e taksapaguesve shqiptarë.


Pamje e Lanës së Lurës.

Po ashtu kam pasur rastin të asistoj në një bisedë tjetër, jo të natyrës që treguam më parë, në zonën e Gjalicave të Lurës, zonë malore midis fshatit Çidhën e Poshtme në Komunën e Arrasit dhe fshatit Gur Lurë të Komunës Lurë, në anën e majtë të rrjedhjes së përroit të Setës.

INTERMEXO HISTORIKO - TURISTIKE

"Në tetor të vitit 2006 shkova në Gjalica jo për probleme mineralesh të ngurta, por për njërin prej mineraleve më të çmuara, që Zoti i ka falur kësaj treve malore, për mineralin e lëngët që e ka emrin **"ujë**", pasi i kisha premtuar komunës të vrojtoja në vend disa burime ujore, ndonëse nuk jam specialist i mirëfilltë për hidrogjeologjinë, për të vlerësuar mundësitë e shfrytëzimit të tyre për popullatën vendase e më gjerë, kryesisht për pirje.

Është vendi këtu të nënvizoj se meqenëse nuk janë bërë monitorime për burimet e kësaj zone dhe meqenëse një pjesë e këtyre burimeve me debit të madh nuk janë në hartat e hidrogjeolgjisë të kryera gjerë në fund të vitit 2005, kjo si autokritikë për shërbimin gjeologjik në përgjithësi, i kisha kërkuar kryetarit të komunës që të na merrte me vete njerëz që kanë njohuri dhjetëra vjeçare për këto burime, kuptohet se këtu bëhej fjalë vetëm për ndryshueshmërinë e debitit sipas stinëve, viteve apo dhjetëvjeçarëve, një monitorim ky **"i papaguar popullor që duhej shfrytëzuar, bazuar në eksperiencën personale".**

Për të shkuar në destinacion, për arsyet që përmenda më sipër dhe të vështirësive që paraqet rruga e Gjalicave, më shoqëruan Dr. Sali Tërshalla, z. Mustafa Tola – mjek, pasionant pas turizmit malor e historisë si dhe qytetarët Met Cani e Beqir Cani ose siç theksova **"monitoruesit e papaguar"** të burimeve.

Pasi kaluam në vendin më të vështirë, ku për rreth 100 m duhej të ecnim të kërrusur nëpër një rrugë rreth 30 cm të gjerë të hapur me mina në formacionet karbonatike të moshës së Trias – Jures, ku poshtë nesh në anën e majtë, humnera e kanionit të përroit të Setës i kalon 300 ml thellësi, vendosëm të bëjmë pushimin e rastit. Përballë nesh shpalosej krenare e madhështore e ashtuquajtura nga vendasit **Kalaja e Skënderbeut**, kala që nga ana ime dëgjohej për herë të parë. Ndërhyj në bisedë, duke u interesuar nëse historianët kanë bërë hulumtime për këtë toponim me vlerë të madhe historike. Ndoshta nuk është vendi për të bërë histori, pasi nuk e njohim këtë fushë, por na habiti fakti se nuk ishin bërë hulumtime a ndërmarrë studime nga ekspedita historike për këtë kala me emërtim të rëndësishëm që hedh sadopak dritë për të vërtetat rreth **pështjellimeve të shumta të origjinës së heroit tonë kombëtar – Gjergj Kastriot - Skënderbeut**, falë të dhënave të fundit sidomos të **Profesorit të shquar e të nderuar të kombit tonë z. Kristo Frashëri**, që konkludon se heroi ynë kombëtar është padyshim nga **Dibra** dhe konkretisht nga **Çidhna, ku dhe ka lindur dhe është rritur në Çelias**, fakt të cilin e përsëriti edhe në emision-

(Vijon në faqe 6)

(Vijon nga faqja 5)

RRUGA E ARBËRIT,
rruga e zhvillimit të Shqipërisë lindore

in javor **të Rudina Xhungës në televizionin TÇ** të këtij fillim viti ku, nuk mund ta fsheh gëzimin dhe krenarinë që më pushtoi kur e dëgjova nga goja e **shkencëtarit të madh**, pasi nga dibranët e apasionuar pas historisë dhe kuvendarët e odave dibrane e kisha dëgjuar dekada më parë.

Pjesa më madhe e rrugës kalonte nëpër trasenë e kanalit të hapur vite më parë, kanal i cili ndryshoi jetën e banorëve të kësaj zone, u ndërtua dhe një hidrocentral i vogël, ndryshoi shumë gjera, por nuk të tërhoqi investime të tjera për këtë mrekulli të natyrës shqiptare, ndoshta nga më të bukurat e saj, u harrua pas marrjes së ujit.

E vështruar nga kjo lartësi, gjarpërimi i përroit ujëplotë e i rrëmbyeshëm, malet si heshta që duket sikur duan të tregojnë diçka për Skënderbeun nga të fshehtat që kanë parë ndër shekuj (të ndërtuara nga shkëmbinj gëlqerorë siç i quan edhe populli) me një reliev të aksidentuar në maksimum, me fenomenet e karstit të zhvilluara në larminë e tyre etj., i miratojnë kanionit të përroit të Setës vlerësimin e dhënë si një perlë e vërtetë e natyrës tonë, e veçantë në llojin e vet në Shqipëri. E ndërsa ecim me një frikë të madhe në zemër për shkak të rrugës së vështirë për t'u kaluar, e cila ndër vite ka marrë shumë jetë njerëzish, siç thotë me zë të ulët Beqiri se është rrugë midis **"jetës e vdekjes"**, në krahun e djathtë herë pas here të tërheq vëmendjen kanioni i Setës, me ujëvarat dhe ujin e kulluar, me troftën aq të dëgjuar, me bimësinë e larmishme dhe pyjet e virgjëra dhe ajo çka na intereson më shumë e për të cilën ne gjendeshim aty, ujët e freskët e të bollshëm, që për habinë e të gjithëve nuk janë vlerësuar e shfrytëzuar, duke u rrekur me burimin e Sopanikës së Çidhnës prej më se 10 viteve, me pompa e prova të pafundme jashtë projekteve cilësore e studimeve shkencore të gjeologjisë e hidrogjeologjisë, me shpenzime të shumta që nuk u dihet fundi, të bazuara në amatorizëm. Kemi rastin të nënvizojmë se, sipas nesh, burimi në fjalë mund të shfrytëzohet e përdoret vetëm për fshatra që janë nën nivelin hipsometrik të këtij burimi, por, gjithsesi, bazuar në studimin e plotë hidrogjeologjik.

Le të kthehemi përsëri në temën e bisedës. Ndonëse erdhëm për tjetër problem, në mendje bluaja mendime për mundësitë e shfrytëzimit për turizëm të këtyre trevave me bukuri të rralla natyrore jo thjesht për faktin se janë të miratuara si monumente të natyrës, por për ato cilësi që përshkruam më sipër. Mendoj se ka ardhur koha e duhet të bëhet diçka, që në këtë zonë të virgjër me një investim shumë të vogël mund të hapet një perspektivë e madhe turistike. Me hapjen e një rruge makine 3 km të gjatë apo me një ristrukturim të një rruge këmbësore 2 m të gjerë, të rrethuar e të siguruar për jetën e vizitorëve brenda standarteve, mundet të ngrihen disa pika shërbimi e restorante moderne, për të shijuar një fundjavë e për t'u magjepsur me bukuritë përrallore të kanionit të Setës, jo vetëm në verë, por edhe në dimër, pasi është vetëm 27 km larg qytetit të Peshkopisë. Jo më kot thonë banorët e këtyre anëve se Seta dhe burimet që e furnizojnë atë janë më të mira e më të ushqyeshme se qumështi e në këndvështrimin e dytë industrializimi tyre, me përmirësimet infrastrukturore në vazhdimësi do të jetë një drejtim tjetër me leverdishmëri të madhe ekonomike."

Rrethi i Dibrës është i pasur edhe me gjeomonumente të tjera të **rëndësisë kombëtare,** ndër të cilët përmendim **ujërat termominerale sulfihidrike në të dy Dibrat**, mineralizimet e **squfurit në Kërçisht**, **rrafshin e Korabit** me lartësi mbi 1500-1600 m, **fushën e Panaireve** me lartësi mbi 2000 m. Po ashtu, në rrethin e Dibrës janë të miratuara dhe një sërë gjeomonumentesh të rëndësisë lokale. Në aspektin e gjeoturizmit malor veçojmë Malësinë e Korabit, me **gjurmët e akullnajave, karstin e zhvilluar dhe peisazhet me kullotat e pafundme alpine.**



Skeptikët e Rrugës së Arbërit le të heshtin, t'i lenë optimistët të vazhdojnë punën e nisur gjer në ndërtimin e saj, se asnjëherë nuk do të jetë vonë së punuari për ndërtimin e Rrugës, pasi këtu fillon e ardhmja dhe rilindja e Dibrës...

Pamje e pjesëshme e Kanionit të përroit të Setës.

Në aspektin e gjeoparqeve ndër më të bukurat e më të rëndësishmet është **ai i Lurës** me biodiversitetet dhe gjeodiversitet si pylli halor me bimësine e lulet karakteristike; liqenet akullnajore; prerjet e amfiboliteve në dysheme të ofioliteve; **Lana e Lurës** (fushë e madhe karstike dhe tektonike) si një nga perlat e kësaj zone ku, vite e vite më parë ka qenë një pikë turistike malore verore mjaft e frekuentuar, e rrethuar nga malet e shumtë dhe e pasur me burime ujore të cilësisë tepër të lartë, ku mund të veçojmë të famshmin **Kroin e Kecit** etj.

Kupolat diapirike gjigante përbëjnë një tjetër gjeoekosistem më vete, me rrudhosjet, bardhësinë, breznimet e bukura, burimet e shumta karakteristike dhe bimësinë e veçantë, duke filluar nga dalja e tyre në mbylljen veriore në përruan e Veleshicës dhe degëzimin e përroit të Bjeshkës së Shehut ose Stredokut (sot pjesë e fshatit Radomirë), në përruan e Gramës, në Vrenjt, në përruan e Llixhave etj.

Që një objekt të jetë monument natyre duhet të jetë vetëm krijesë e natyrës**, të ketë vlera të mëdha shkencore, estetike, kulturore, historike, didaktike, fetare dhe të jetë i padëmtuar nga njeriu.**

Në lidhje me përcaktimin dhe inventarizimin e monumenteve të natyrës në rrethin e Dibrës, do të konkludonim se studimet në këtë fushë lënë për të dëshiruar në shumë drejtime, kjo dhe për faktin se me këto punime janë marrë specialistë me njohuri jo të plota për problemet në fjalë dhe miratimi i tyre në bazë nga institucionet pyjore, gjeologjike, arsimore (gjeograf, biolog etj.,) ka munguar, duke lënë shteg për një punë diletante, pa hyrë në saktësitë e përshkrimit të monumenteve në fjalë dhe trajtimet në botimet e bëra, që lënë shumë për të dëshiruar.

U zgjatëm jo pa qëllim në trajtimin e këtij problemi për faktin se monumentet e natyrës në kompleksitetin e vet duhen parë e vlerësuar edhe në aspektin ekonomik, pasi prej tyre përfitimet do të jenë të shumta dhe kjo siguri do të shumëfishohet me ndërtimin e Rrugës së Arbërit, **rrugë për të cilën profesori i nderuar dibran, historiani, arkeologu pasionant e kurajoz, i palodhuri Iljaz Kaca, së bashku me kolegun e tij, që për asnjë çast nuk ka reshtur së propaganduari rëndësinë e ndërtimit të kësaj rruge, Hysen Uka, (ku gjej rastin t'i falenderoj edhe për punën e mirë në udhëheqje të shoqatës "Nisma Dibrane") i janë përkushtuar ndër vite me pasion e durim (duke përballuar me gjakftohtësi edhe ndonjë "ofendim" të kundërshtarëve dritëshkurtër të saj) sensibilizimit të të gjithë opinionit shqiptar brenda e jashtë kufijve, për rëndësinë që ka kjo rrugë jo vetëm për Dibrën, por për gjithë Shqipërinë lindore, në rajonin ballkanik e më tej.**

Që një objekt të jetë monument natyre duhet të jetë vetëm krijesë e natyrës, të ketë vlera të mëdha shkencore, estetike, kulturore, historike, didaktike, fetare dhe të jetë i padëmtuar nga njeriu.

REZERVAT HIDROENERGJITIKE, PASURI TË PASHFRYTËZUARA

Dibra, një rreth malor me një sipërfaqe rrotull **1030 km²**, me një rrjet hidrik të larmishëm, me disnivele të kënaqshme, me ujë të bollshëm etj., më ka tërhequr prej kohës vëmendjen në drejtim të mundësive që ka për ndërtimin e **H/Ç të vegjël**, pa dëmtuar mjedisin, pa dëmtuar tokën bujqësore dhe me kosto të ulët e mjaft fitimprurëse. Personalisht nuk jam ekspert në këtë fushë, por më ka ngacmuar në këtë drejtim njëri nga miqtë e mi të ngushtë, të cilin e citova më sipër, **Prof Kodra**, për rastësi edhe ky me origjinë dibrane. Në një takim që kam pasur kohët e fundit me të më ka habitur për punën kolosale që është bërë në **Kosovë** nga një grup i madh specialistësh, pikërisht për të evidentuar, studiuar e caktuar në terren vendndërtimet e tyre. Tani që **drita jeshile** për **Rrugën e Arbërit** është dhënë dhe mundësitë e lëvizjes do të jenë tejet më të mira, mendojmë se jemi në kohë e ndoshta pak të vonuar në ndërmarrjen e një sërë iniciativave private për ndërtimin e **H/Ç të vegjël** në gjithë territorin ku studimet e projektet do të flasin me gjuhën e specialistit. Gjej rastin të nënvizoj jo vetëm **gatishmërinë e profesorit për të kontribuar** në këtë fushë mjaft aktuale e me leverdi të madhe, pasi shpenzimet e ndërtimit që kërkojnë kanë vlera të vogla, po nënvizoj në vija të trasha se, në kuadër të një studimi të bërë vitet e fundit nga ish Dega Rajonale e Gjeologjisë së Peshkopisë (Hartës së Rrezikut Gjeologjik për Rrethin e Dibrës në shk. 1 : 50 000), janë hedhur disa ide se ku mund të ndërtohen këto vepra hidroenergjitike.

Përroi i Mallës së Lurës, përroi i Setës, përroi i Murrës, Përroi i Veleshicës, përroi i Peshkut në Selishtë, përroi i Gramës, përroi i Llixhave, liqeni artificial i Gramës, ujësjellësi i Preshit etj., etj., janë disa nga vendet ku mund të fillojë menjëherë studimi, projektimi e ndërtimi i tyre. Falë disniveleve që ofron morfologjia e zonave ku kalojnë këto përrenj, mendojmë se metoda **me devijim të ujit nga shtrati i përroit** e deri në vendin ku fitohet disniveli i kërkuar do të jetë mënyra më kryesore sesa ajo e mikrodigave, pasi këto të fundit kërkojnë më shumë studime e vlerësime të detajuara, për rrjedhojë kosto të lartë ndërtimi dhe mundësi të madhe mbushje nga deluvionet e proluvionet që sjellin përrenjtë në fjalë.

Unë kam mendimin që në faqet e kësaj **gazete duhet të japin mendimet e tyre specialistë të fushave të ndryshme**, pasi ndikimet e Rrugës së Arbërit do të reflektohen në shumë sektorë të ekonomisë, ku shtimi i parcelave **me drufrutorë**, rritja e **prodhimeve blektorale**, sidomos prodhimi i djathit nga qumështi i dhisë për diabetikët dhe shtimi i **një sërë prodhimesh të tjera bujqësore** specifike e me leverdi për klimën e Dibrës, do të kërkojnë një treg më të madh, një industri përpunimi në vend, çka padyshim këtë mundësi do ta ofrojë e nxisë **Rruga e Arbërit, rruga e zhvillimit**. **Skeptikët e Rrugës së Arbërit** le të **heshtin**, t'i lenë **optimistët** të vazhdojnë punën e nisur gjer në ndërtimin e saj, se asnjëherë nuk do të jetë vonë së punuari për ndërtimin e saj, pasi këtu fillon **e ardhmja dhe rilindja e Dibrës...** e **kësaj Dibre** që lindi e rriti edhe të madhin **Skënderbe**.

Mendova t'i mbyll këto shënime **"të hallakatura"** me një strofë të **poeteshës së persekutuar dibrane Shane Muda** (mbesës së të ndjerit **Mustafa Shkurta nga Zimuri**, inxhinierit asistent e të talentuar që u kushtoi jetën kërkimeve gjeologjike), të titulluar: **Më thuaj një fjalë:**

Të eci buzë greminës e të mos rrëzohem, të eci mes shkretëtirës e të mos venitem, të eci mes stuhisë e në të të ngrohem - Më thuaj një fjalë!

Fotot ilustruese të shkrimit janë të autorit

Një vështrim perëndimor për Lurën

Nga Prof. Dr. SHABAN SINANI



Ndonëse e largët dhe e fshehtë, gati e pambërritshme, përveçse në përfytyrim, jo për shkak të thellësisë dhe lartësisë alpine ku gjëndet, si dhe vështirsive dhe rreziqeve të udhëtimit, por edhe për misteret e saj ende të pashfaqura, Lura historikisht ka qenë një vatër tërheqëse për mysafirë të shquar, vendas e të huaj, që ka ndezur fantazi nga më të çpenguarat. Figura të nderuara të arteve e të diturisë, misionarë të zbulimit të ekzotikës së këtij këndi të mënjantë të kontinentit europian, shtegtarë që i ka çuar rasti, gjeneralë, klerikë, shkencarë, turistë, investitorë, ekologë, politikanë, natyralistë, qysh prej kohësh të shkuara, të sunduar prej pasionit të së bukurës dhe së panjohurës ia kanë dalë të mos largohen nga Shqipëria plot hijeshi natyrore pa parë edhe Lurën. Siç konstatohet në pështypjet e tyre, të botuara në shumicë vendesh, kryesisht të Perëndimit: në Austri, në Angli, në Kroaci, në Gjermani e në Hungari, udhëtimet për në Lurë kanë qenë plot befasi nga më të çuditshmet: vizitorët e huaj i kanë nisur ato në formë eskursionesh "prej Adriatikut në Drin të Zi" dhe kanë vazhduar më tej nga besa e një katundi në besën e tjetrit; të mbrojtur prej fëmijësh pa vënë pushkë në krah dhe jo rrallë edhe nga vajza të reja të gjendura nën favorin e 'karareve të vendit", krahas të tjerëve të siguruar me roje ushtarake; nën kërcënimin e rrebesheve të motit;me harta topografike ose pakurrfarë mjeti orientimi; me kuaj, duke kapërcyer vahe lumenjsh, ku punën e lundrës e ka bërë njeriu vetë; me mjete gjithëfarëshe udhëtimi, qysh prej karrocave, deri tek helikopterët. Dy udhëpërshkrime që meritojnë për t'u shqyrtuar për interesa njohje publike i takojnë fillimit të shekullit të 20-të e këndej. Por gjurmët e shtresave më të vjetra të kulturës së krahinës në mënyrë të tërthortë flasin për një hershmëri më të madhe të interesit të të huajve. Specialistët arkeologë ende flasin sipas vëzhgimeve rastësore me sy, sepse faktikisht deri tani nuk është bërë asnjë gërmim, qoftë edhe amator, atje ku gjenden rrënojat e këtyre shtresave kulturore. Prej studiuseve është përmendur një degëzim i Egnatias antike, i cili sipas shpjegimit popullor, vjen prej Elbasanit dhe ndjek drejtimin e verilindjes mes përmes zonës së Lurës deri në Prizren e më në veri (disa nga puset e ujit të pijshëm që kanë qenë hapur në të dyja anët e kësaj rruge ruhen ende në gjendje të rregullt);dy qyteza me mure rrethues ndërtuar me blloqe gurësh masive, në Borie dhe në Ndërshenë; një varg toponimesh me karakter historik e legjendar që dëshmojnë gjurmë periudhash historike të mugëta ku vlen të veçohet supozimi për një barazim etimologjik sipas ligjeve të fonetikës historike të shqipes Ilyri-Lurë, si dhe një tog emërtimesh më të ngushta me burim etimologjik të shpjeguar prej trajtave latine. Përveç Ms. Edith Durhamit dhe Baron Nopçës, Shtjefën Gjeçovit dhe Gjergj Fishtës, kolonelit britanik Maklin dhe shkrimtarit të mirënjohur të kohëve të reja Ismail Kadare, njoftime të shumëllojshme me karakter historik , gjeografik e bio-natyralist, kulturor e etnologjik kanë dhënë edhe një varg figurash të tjera të mendimit dhe kërkimit që për arsye të ndryshme, kanë mbetur larg vëmëndjes publike."Një prej tigrave të Dibrës' sipas Durhamit "një nga kështjellat e fundit të virtytit' sipas Nopçës; Lura me çka përreth është vizituar edhe nga specialist të shkencave të reja; topografë të ushtrisë, të cilët sigurisht kanë hartuar relacione dhe përpiluar të dhëna që duhet të gjenden në arkivat e instituteve të saj;spedologë, ambientalistë, dialektologë, etnografë dhe folkloristë.Midis këtyre vizitorëve, dy prej tyre, me dy vepra pothuajse të panjohura, janë pritur si mysafirë të Lurës në dekadën e parë të shekullit të kaluar.Veprat janë:'Nga Adriatiku në Drin të Zi' dhe "Udhëtim nëpër Shqipëri" gjërësisht të inxhinierit austriak Karl Steinmetz dhe të fratit kroat Lovro Mihacevic, provincial i parë i provincës françeskane të rithemeluar në vendin tonë para shpalljes pavarsisë në korrik të vitit 1906.

Këtu do të përpiqemi që të shmangemi prej frymës romantike që i cilsuar udhëpërshkrimet e asaj kohe, si dhe prej emocioneve vetjake të autorëve, duke dashur të nxjerrim në pah se çfarë është Lura me syrin e një të huaj.

Interesim kryesor i dy udhëpërshkruesve që përmendëm në librat e tyre të botuar përkarësisht në Vienë dhe në të mirënjohurën "Matica Hrvatska" të Zagrebit është Lura si ekosistem, njeriu dhe natyra, bashkëjetesa e tyre në ekuilibre të qëndrueshëm, të formuar prej traditash shekullore, marrëdhënjet e tyre të shumëfishta, që prej atyre ekzistenciale, deri tek ato estetike. Padyshim që tërheqje e dorës së parë kanë qenë bukuritë natyrore të krahinës dhe fuqia e tyre i ka nxitur vizitorët t'ua përshkruajnë ato edhe të tjerëve që nuk kanë pasur mundësi të venë për ti parë në vend.

Në të dy librat ka përshkrime të mjediseve malore të krahinës, të bimësisë, sidomos të asaj me vlera shëndetësore; të liqeneve me prejardhjen e tyre. Është për tu shënuar se vetë vendasit, ndonëse nuk paraqiten duke u shprehur drejt për drejt për vlerat natyrore të truallit ku banojnë, janë të vetëdijshëm, se jetojnë mbi thesare të cilat nuk dihen se ku gjenden , por ama nuk mund të lejojnë që një i huaj të shkojë e t'i kërkojë, ndoshta edhë t'ua grabisë. Këto thesare në të vërtetë janë dhuntitë e pakursyera të natyrës vlerat kurative dhe rikrijuese të saj, mjedisi mahnitës dhe i begatë, me mundësi të larmishme për të ushtruar gjithfarë veprimtarish, qysh prej atyre sportive deri tek turizmi dhe aktivitete të tjera shëndetsimi. Në vështrimin e të huajve Lura paraqitet si një rezervat natyror vlerash të papërsëritshme, që mund të fillojnë me zambakun e bardhë të liqenit të luleve dhe mund të përfundojnë me ujrat me fortësi natyrore mbinormale.Pikërisht ky fakt ka përftuar e ka mbajtur të ndezur nën vetëdijën e lurianëve me mendimin se ai vend është i mbushur me pasuri të nëndheshme, ide që i ka çuar deri atje sa të reagojnë me xhelozi e rezervim kundër kërkimeve të huaja. "Porsa kishte filluar ngjitja në shpinën e pjerrët të pyllit të Kunorës u detyruam të ndaleshim nga oshëtima e thirrjeve nga larg , shkruan inxhieri austriak Karl Steinmetz. Pyesnin se çfarë kërkonim atje lart. Pas përgjigjes tonë do të shkonim tek liqejit ata na kërkuan të kthehesim .Ne vazhduam rrugën, por menjëherë mbrapa nesh u dëgjua gjallëri.Shpejt pamë njerëzit të armatosur duke nxituar drejt nesh nga anë të ndryshme.Na thanë përsëri të kthehesim, kësaj radhe duke na kërcënuar se do të shtinin.Meqë çdo kundërshtim ishte marrëzi, pas një këshillimi të shkurtër vendosëm të të bindeshim. Në livadh na priste një grup burrash të zemëruar, që donin të dinin:çka dëshironim atje lart? Po i huaji çka don në Lurë? Mos ka ardhur të hetojë thesarët e fshehura atje lart në thellësi të tokës?Një gjë e tillë nuk do të lejohej''Ndërsa frati kroat Lovro Mihacevic vëren me keqardhje se "bota idilike" e zonës është e"mahnitshme dhe magjepsëse në vetvete, por njëherësh e braktisur'Interesim tjetër i rëndësishëm i këtyre autorëve në librat e tyre është Lura si etnokulturë.Sipas Ms. Durhamit "Lura mbahet në kanun të Lekë Dugagjinit", por nga shqyrtimet më të imëta të misionarëve paraardhës dëshmohet se Lura paraqet një njësi etnokulturore ku kryqëzohen dhe interferojnë nocione të së drejtës zakonore të dy kanuneve kryesore të veriut të vendit , që njihen respektivisht me emrat e dy figurave qendrore të rezistencës mesjetare:Lekë Dugagjinit dhe Skënderbeut, i pari"i lekëve" dhe i dyti i "gegeve" .kjo përputhet edhe me gojëdhënën e njohur historike mbi ndarjen e zonave të sundimit të dy prijësve arbër, që thotë se shtegarët e nisur nga të dy krahët njëherësh nga një largësi e barabartë për të ndarë kufirin u takuen pikërisht në Lurë. Vetë vendasit i referohen edhe njërit kanun edhe tjetrit. Shumë gjyqësi janë ndarë "në gojë të kanunit të Lekës', por edhe ka gjyqësi të ndara 'n'kanu të Skëndërbeut'.Në anën tjetër siç është vënë në dukje, përveç vetë njohësve vendas dhe specialistëve, në të drejtën zakonore të Lurës themelin e përbëjnë 'kararet e vendit", të ashpra dhe burrërore njëherësh, si ilustrim të të cilave do të përmendim këtu të drejtën e njeriut të rënë në gjak për të mos ia trazuar në asnjë rrethanë kafen e mëngjezit. Mund të pohohet me siguri të plotë se në stinët e vështira të vitit 1944 nuk kanë qenë aq bukuritë natyrore të Lurës sa urtësia e kuvendit të saj, si dhe një pozitë e njohur etnokonore në krahinat përreth, që bënë që koloneli britanik Maklin, siç shkruan në librin e tij "Illyrian adventurë", ta preferojë atë si një vend të një mbledhje të rëndësishme të krerëve nacionalistë, mbledhje e cila njihet në histori me emrin e kësaj zone, ndonëse nuk u arrit të kryhej, për shkaqe ende të pashpjeguara në mënyrë përfundimtare.

Është vënë në dukje vëmëndja e posaçme e vizitorëve të huaj dhe e njerzve të ditur ndaj mikpritjes dhe gjakmarrjes. Këto dy dukuri të jetës tradicionale të Lurës zënë vend qendror edhe në përshkrimet e dy autorëve që po u referohemi."Prej malit të Shenjtë zbresim në fshatin Krejë të Lurës, ku na u desh të ndërrojmë shoqëruesin. Konstatuam se nuk gjendej burrë përjashta. Të gjithë janë ngujuar dhe nuk guxojnë të dalin sepse i tremben gjakmarrjes', shënjon frat Lovro Mihacevic. Ndërsa austriaku Steinmetz shprehet se 'në asnjë zonë tjetër të Shqipërisë nuk shihen kaq pak burra përjashta;ato ruhen nga plumbi i gjakmarrësit'Të dhëna të rëndësishme jepen nga këto autorë për orientimin shpirtërorë të banorëve të Lurës së periudhës parashtetërore. Të dy konkludojnë se vendasit e shohin shpëtimin e tyre dhe të gjithë Shqipërisë vetëm nga një fuqi e tillë politike siç ishte Austro-Hungaria.E vërteta historike për ngjarjet që u zhvilluan më vonë, e shtjelluar dhe pranuar nga analistë të diplomacisë, rezulton se kjo prirje intuitive e malsorëve të Lurës nuk qe aspak e gabuar dhe se kombinacionet e interesavre të fuqive të mëdha Austro-Hungaria qe faktori i jashtëm më i rëndësishëm i pavarsimit të Shqipërisë.Madje këto ngjarje treguan se edhe dyshimet e shfaqura nga bashkëbisedues të vizitorëve të huaj mbi sinqeritetin e politikës italiane nuk qenë të pabaza. "Këtu në Lurë, shkruan Steinmetz, provova se në malet e Shqipërisë influenca e vjetër austriake është e padobsuar fare dhe se kundërveprimi italian po shënon ndonjë sukses vetëm në bregdet. Nemsja (Austro-Hungaria) në brendi të vendit është shumë pak e njohur dhe një koncept fare i zakonshëm për këdo.


Populli e di se klerikët e tij edukohen me Nemse nga ana profesionale dhe se konsujt e monarkisë ua mbrojnë të drejtat".Ndërsa provinciali i franceskanëve shqiptar Mihacevic konkludon se "në bisedë këtu të gjithë janë të sjellshëm dhe të njerzishëm;ata presin që mjerimit të tyre t'i jap fund njëherë e mirë Austria ose Nemsja, siç i thonë në gjuhën e vendit"Këto konstatime mbi lidhjet shpirtërore me botën e lurianëve të dikurshëm janë vrojtuar nga të huajt në një periudhë kur gjithë Shqipëria ishte pjesë e perandorisë turke dhe e ardhmja e vendit ishte krejt e errët. Shekujt e sundimit të gjatë otoman nuk kishin munduar ta çrrënjosnin nga nënvetëdija e shqiptarëve prirjen e qëmoçme për miqësi me vendet më të përparuara të kontinentit, me të cilat, siç kanë konkluduar historianët, deri në mesjetë Shqipëria ishte zhvilluar me një hap, në nivel të barabartë.

Për të huajt që kanë vizituar Lurën në kohëra të hershme ka qenë një zbulim i vërtetë bashkëjetesa dhe alternimi i lirshëm i besimit deri në nivelin e familjes. Në shkrime etnografike dhe publicistikë shpesh shembulli i Lurës është bashkërenditur me atë të Shpatit të Elbasanit, ku deri në dekadat e fundme ka mbijetuar krishtërimi i fshehtë ose besimi i dyfishtë. Në të vërtetë ngjashmëria është e madhe, por bashkërendimi nuk është krejt me vend.

(Vijon në faqen 8)

Sali, hapi dy arteriet koronare të Shqipërisë

Nga ABDI BALETA



Ekemi fjalën jo për një përkujdesje shëndetësore që hyn në veprimtarinë e kardiologut, por për dy arteriet më të rëndësishme rrugore, autostrada Durrës-Morinë dhe ajo përgjatë Rrugës së Arbrit, që kanë nevojë për një kujdes të veçantë qeveritar e kryeministror për t'u përfunduar sa më shpejt e sa më mirë.

Të dy këta akse rrugore kanë për mekanizmin shtetëror e organizmin kombëtar të shqiptarëve po atë rëndësi që kanë për zemrën dy arteriet koronare. Ndërtimi i këtyre dy akseve rrugore i jep shëndet të paparë gjithë organizmit kombëtar shqiptar, lidh shumicën e trevave të banuara nga shqiptarët dhe shumicën e popullsisë së përgjithshme shqiptare në Ballkan me zonën Tiranë-Durrës, qendrën më të madhe të veprimtarive ndërshqiptare, si dhe të shqiptarëve me botën perëndimore. Zona Tiranë-Durrës që ka marrë tashmë edhe pamjen e një qendre të madhe tërheqëse për gjithë hapësirat shqiptare në Ballkan, është njëkohësisht edhe porta më e përshtatshme e gjithë Ballkanit dhe e Lindjes drejt Perëndimit dhe porta më e përshtatshme e Perëndimit drejt Lindjes. Prerjet me autostradat Veri-Jug u shtojnë më shumë vlerën dy arterieve të mëdha koronare shqiptare, por nuk kanë atë rëndësi as atë përfitim të gjithanshëm që kanë këto.

Duke pasur parasysh leverditë e shumta ekonomike, politike, kulturore, turistike për kompaktësimin e kombit shqiptar dhe shtimin e lidhjeve me kombet të tjerë këto dy akse duhej të ishin tashmë të përfunduar e në funksionim të plotë. Por për fat të keq punët nuk kanë shkuar si duhet. Edhe fjalët e pakta e premtimet e vakta që janë bërë deri tani kanë mbetur pa efekt. Sa herë ka pasur fushata zgjedhore pushtetarë e politikanë kanë lëshuar ndonjë tullumbace propagandistike për ndërtimin e këtyre akseve, sidomos të atij më parësorit Durrës-Morinë. Janë bërë ndoshta dhe disa projekte gjysmake për këtë aks e lëshuar ca projekt-ide për aksin tjetër, Rrugën e Arbrit që do të afronte në kohë dhe në hapësirë me Tiranën e Durrësin më shumë se një milion shqiptarë.

Në fushatën e tanishme kryeministri Berisha qenka shprehur: "Do të sakrifikohet çdo projekt për rrugën "Durrës-Kukës" (gazeta ABC, 8 shkurt 2007). Gjatë mitingut në Peshkopi dhe "premtime kryeministrore", jo thjesht premtime prej një kryepartiaku në fushatë politike, edhe për aksin tjetër të Rrugës së Arbrit. Sikur të mbajë këto dy premtime kryeministri i vendit, Berisha, do t'i bëjë shërbimin më të mirë shqiëprisë e kombit shqiptar dhe nderin më të madh qeverisë e emrit të tij. Po të realizojë këto dy projekte do të mbahet mend për mirë, pavarësisht se si mund t'i kenë shkuar e mund t'i shkojnë punërat e tjera.

Për të mbajtur këto dy premtime kryeministri Berisha nuk duhet ta vrasë mendjen fare se çfarë mund të thonë kritikët e tij për të, kur të mbetë pa ubërë ndonjë punë tjetër. Kryeministri Berisha duhet të fitojë kohën që ka humbur pushteti në Shqipëri për përfundimin e këtyre dy projekteve të ngutshëm. Rruga Durrës-Kukës mund të ishte përfunduar sikur nën qeverisjen 8-vjeçare të socialistëve të kishte ekzistuar vullneti i mirë politik me interes mbarëkombëtar dhe kujdesi pushtetar-administrativ territorial. Por tashmë kemi arsye të besojmë se edhe atëherë kur është folur sa për sy e faqe për ndërtimin e këtij aksi, kjo më tepër është bërë të maskuar mungesën e dëshirës për përfundimin e tij të shpejtë.

Një ish-kryeministër, Pandeli Majko, ende vazhdon të mburret se ka qenë ideatori i taksës së veçantë për ndërtimin e rrugës Durrës-Kukës. Por kjo taksë përfundoi në një mbitaksë të paligjshme për të mbyllur qeveria vrima të tjera në gardhin e shpartalluar të administrimit të keq të saj. Kjo taksë shërbeu më shumë për të penguar se për të pështjetuar punën. Një tjetër ish-kryeministër, Fatos Nano, ka shkuar një herë të pozojë, sa për propagandë, pranë disa makinerive të xhenios ushtarake që ishin grumbulluar për njëfarë kohe të hapnin një copë trase. Dhe me kaq kujdesi mbaroi. Nano nuk mungoi në fushatën elektorale të vitit 2005 në një miting në Peshkopi ta përmendte Rrugën e Arbrit. Me kaq mori fund kujdesi i tij. Një ish-kryeministër tjetër, Ilir Meta, sikur nuk e kemi dëgjuar as të bënte demagogji për hapjen e këtyre dy arterieve koronare të Shqipërisë, ndonëse edhe ky mburrej si ndërtues i pasionuar rrugësh.

Tani që kryeministër është një kardiolog na e ka qejfi të shpresojmë më shumë se do të hapen arteriet koronare rrugore, sidomos pas betimeve që ka bërë këto ditë në fushatë elektorale. Aksi Durrës-Kukës duket se ka hyrë tashmë në rrugën pa kthim të ndërtimit, pavarësisht nga pengesat që duan të nxjerrin disa partiakë të lartë opozitarë me pretendimin se do të kushtoka "një djall e gjysmë". Le të kushtojë edhe "një djall e tre çerekë" edhe "dy djaj bashkë", por nuk mund të zvarritet më nisja e punës në stil të gjerë, megjithëse vështirësitë e qeverisë për të rregulluar gjithë problemet që dalin, sidomos aspektin e financimit, nuk quhen ende të kapërcyera.

Nuk është kapërcyer as rezistenca politike që i bëhet ende ndërtimit të këtij aksi, nga forcat politike që janë në opozitë, nga politikanë inatçorë që kanë mbetur robër traditës së keqe të kohës së diktaturës së keqe të kohës së diktaturës për ta trajtuar Veriun e Shqipërisë me syrin e njerkës, që për më tepër tani nuk duan ndërtimin e arterieve të fuqishme transporti drejt Kosovës e Shqipërisë Lindore. Shumë politikanë kryesorë socialistë me shkrime kanë treguar se janë robër të mentalitetit të pushtetit të dikurshëm të klaneve labogjirokastrite që Veriu të ishte zonë shfrytëzimi intensiv e investimi me pikatore. Fillimi me shumë vonesë, ritmet e ulëta të ndërtimit dhe braktisja e lehtë e trasesë së papërfunduar të hekurudhës Milot-Rrëshen-Klos është shembull i qartë si bëheshin investimet në zonat e Veriut. Mjaft shenja të zvarritjes së rrugës Durrës-Kukës flasin për gjasa që kështu të veprohej edhe këtu.

Ka dhe qytetarë që thartojnë turinjtë nga ndërtimi i këtyre rrugëve. Dalin ende shkrues si një Mihallaq Qileri që numërojnë sa mallra konsumi e sa shërbime të tjera kalimtare mund të përballoheshin me ato para që do të harxhohen, sipas tij kot së koti, për të bërë një rrugë të madhe drejt Kosovës. Zëra të tillë përsëri nuk janë të rastit.

Ka vite që në emër të mbrojtjes së ambientit në gjirin e Vlorës kurdisen deri protesta popullore kundër ndërtimeve të planifikuara të impianteve për prodhim energjie elektrike. Edhe tani që u nënshkrua kontrata vetëm për një TEC me një kompani italiane përsëri në gazeta lexojmë tituj kushtrimdhënës "Berisha nuk mbajti premtimin dhënë vlonjateve. Acarohet Vlora, nënshkruhet ndërtimi i TEC-it". Ama energji elektrike kërkojnë edhe banorët e Vlorës, veçse ajo duhet të prodhohet diku gjetkë dhe të vërshojë drejt tyre nëpër tela.

Kurse ZP-ja" e datës 16 janar 2007 nuk ka nguruar të botojë me tituj të mëdhenj në një sfond të zi "Berisha pengon ndërtimin e hidrocentraleve. Korrupsioni Berisha pengon koncesionin e Skavicës". Në Skavicë nuk është fjala për një "dëmtim mjedisi", por për përmbytje përgjithmonë nën ujë të gjithë pellgut të Dibrës, për cenim jo thjesht të pronës, por edhe të vendbanimit, të kujtimeve historike, të varreve të të prëve, të trashëgimive shekullore të rrënjëve etnokulturore të një krahine të tërë. "ZP-ja" e kërkon sa më shpejt këtë që nuk e bëri qeverisja socialiste dhe do që ta realizojë Berisha. Këtu kujdes, zoti kryeministër, se kjo është punë që duhet menduar mirë. Dibra pasi të zhytet nën ujë nuk del dot më.

Midis zërave që janë kundër hapjes së arterieve koronare të Shqipërisë ka disa që shprehin edhe urrejtjen serbe e greke që erdhi koha për shqiptarët të lidhen sa më ngushtë me njëri-tjetrin, që shqiptarët të përballojnë të gjithë bashkarisht më mirë problemet e lëvizjes, të turizmit të brendshëm e ndërkombëtar, të lidhjeve me botën e jashtme nga portet e tyre, të energjetikës duke u bazuar në burimet e tyre të diversifikuara, të shkëmbimit midis tyre të prodhimeve bujqësore në varësi të sezoneve e mikroklimave të ndryshme që kanë territoret shqiptare.

Prandaj urojmë që kryeministri Berisha ndërtimin e këtyre dy arterieve rrugore ta marrë si aksionin më të madh të veprimtarisë së tij politike dhe të mos ua verë veshin atyre që duan ta pengojë me fjalë e të mos lejojë ata që duan ta pengojnë me veprime. Urojmë që edhe fjalët e thëna në Peshkopi për Rrugën e Arbrit, të mos jenë si fjalët e mira e gurë në trastë që pat thënë ish-kryeministri Nano në të njëjtin qytet gati dy vite më parë, as si ai premtimi tallës që u bëri para shumë vitesh ish-kryeministri Aleksandër Meksi matjanëve të mbledhur për miting në Burrel se do të hapte një tunel që ta lidhte këtë qytet me Fushë-Krujën.

Marrë nga gazeta "Rimëkëmbja", 13 shkurt 2007

(Vijon nga faqja 7)

Një vështrim perëndimor për Lurën

Në Lurë bashkëjetesa e besimeve shprehet në zgjedhjen e lirë të tyre, pa ndonjë paracaktim në formën e traditës ose të detyrimit prej brezave paraardhës. Për shkak të ndikimit pothuajse të paqenë të administratës turke në këtë zonë, të paktën në fazën e fundme, njeriu nuk ka qenë i detyruar ta fshehë besimin e tij duke mbajtur dy emra, duke u falur në dy tempuj, duke kremtuar dy rituale. Ndoshta Lura është zona më e përshtatshme për thënjen e njohur të Ms.Durhamit se për shqiptarët profeti më i mirë është ai që sjell më shumë dobi dhe përfitime. "Ne ishim në shtëpinë e kryeplakut të Lurës, që vetë ishte katolik dhe vëllain prej nëne e babe e kishte musliman. Njëri festonte krishtlindjet dhe njëri bajramin. Fëmijët e njërit ishin Gjon e Pjetër, kurse të tjetrit Sulë e Osman. Në Lurë katoliku i jep vajzën e vet muslimanit dhe ky po ashtu katolikut. Në raste kur mesha është popullore muslimani vjen me rroba të shtrenjta", vëren i mahnitur frat Lovro Mihacevic, ndërsa inxhineri austriak sheh që, ndonëse shumica e banorëve të Lurës është me besim musliman, "askujt nuk i shkon në mendje t'i mohojë familjes së Bibë Kolës titullin e trashëguar tash e sa breza të kullës së parë" të zonës. Ai çmon gjithashtu si shprehje të një tolerance të theksuar faktin tjetër që bajraktari i Lurës është Ali Mena, muhamedan, dhe askush nuk pretendon për të ndryshuar pozitën e tij nga ana e katolikëve. Së



fundmi janë me të vërtetë befasuese njoftimet që përmbajnë librat e këtyre dy autorëve mbi një aspekt krejt të panjohur të karakterit të banorëve të dikurshëm të Lurës. Nëse joshja e të huajve për të prekur me dorë bukuritë e saj ka qenë e fuqishme, nuk ka qenë aspak më i zbehtë pasioni i lurianëve për të parë botë, për të njohur vise të largëta, për të mësuar kulturë të popujve të tjerë. Në një zonë aq të izoluar prej kushteve natyrore mysafirët e largët gjejnë njerëz me të cilët mund të komunikojnë jo vetëm në turqishte, që ishte gjuhë zyrtare e pushtetit të atëhershëm, por edhe italisht apo gjuhë të tjera. Dhe nuk bëhet fjalë për raste të klerikëve, që i merrnin njohuritë e gjuhëve të huaja jashtë vendit. "Më tepër se gostia që përbëhej nga supa e orizit, mishi i pjekur i dashit, orizi me qumësht, kosi e djathi, më interesoi njëri nga tre vëllezërit e Gjetan Ajazit ku isha i ftuar, i cili për habinë time jo të vogël, merrte pjesë me lehtësinë më të madhe në bisedimin italisht me priftin. Për shkak të vrasjes të një agjenti të qeverisë turke Selman Ajazi u detyrua të ikë në Kotorr pastaj në Itali. Atje mësoi shkrim e këndim dhe përqafoi kristianizmin, duke marrë emrin Simon, shkruan Steinmetz. Por befasia e tij bëhet më e këndshme kur një prej të ftuarve i lutet ta marrë me vete në Austri. "Ai më pyeti nëse mund të fliste me kaizierin, nëse mund t'i jepte ndonjë dhuratë dhe çfarë dhurate do të pëlqente më shumë." Këto njoftime të të huajve janë njëherësh shprehje e një disponimi mirëdashës të tyre, që nuk ka munguar edhe në kohë më të afërta. Fryma e miqësisë që i përshkon librat e tyre, si dhe respekti që gjejnë në popullsinë vendase, janë premisat e nevojshme për ndërkomunikim të lirë njerëzor. Lura ka shumë ç'të paraqesë përpara vizitorëve të huaj, ka zbulime të vërteta estetike, natyrore e humane; por respektin e kërkon edhe nga të tjerët për veten.

Ali Hoxha, veterani i gjurmëve të diturisë

Nga MEVLUD BUCI


Ali Hoxha u lind më 14 mars 1940 në fshatin Laçes të Çidhnës në Dibër. Rrjedh nga një familje me tradita atdhetare dhe fetare prej 7 brezave imam i krahinës së Çidhnës. Stërgjyshi, Abdurrahmani, për trimërinë që tregoi si udhëheqës i popullit të Çidhnës në luftërat kundër pushtuesve të huaj në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, sidomos ndaj pushtuesve serbë, populli e njihte me emrin Hoxhë Kuta me kobure, hoxha i 12-të mijëve dhe Hoxha i Shehit të Thatë. Këto epitete ia vunë për rrjedhojë të shembullit atdhetar si prijës popullor dhe qëndrestar për mbrojtjen e lirisë e të atdheut. Trupat pushtuese serbe që në vitet 1913-1914 kishin pushtuar Dibrën, u detyruan të largonin nga masakrimi rreth 80 burra, të cilët i kishin grumbulluar me mashtrim në vendin e quajtur Kodër Leshe, vetëm atëherë kur tuxhari (tregtari) i Çidhnës me emrin Mark nga Belica, i paralajmëroi serbët se në rast masakrimi të atyre çidhnakëve, atëherë mbi trupat serbe do të binte ndëshkimi i Hoxhë Kutës nën komandën e të cilit ishin rreth 12 mijë luftëtarë në Shehër të Thatë. Ndërsa babai i Aliut, Adem Hoxha, në janar të vitit 1940 për veprimtari patriotike e antifashiste ndaj pushtuesve italianë e internuan në kampin e përqendrimit nazifashist në ishullin e Ventotenës në Itali. Gjithashtu, në luftë për mbrojtjen e kufijve të atdheut tonë nga sulmet e monarko-fashistëve grekë në zonën e Bilishtit të Korçës në gusht të vitit 1949, Ademi u dekorua nga Presidenti i Shqipërisë me "Medaljen e trimërisë". Për motive fetare Ademi kurrë nuk pranoi të bëhej anëtar i PPSH edhe pse i provuar në luftë për atdhetarizmin e tij. Për motive fetare Ademi ka qenë i diskriminuar në kohën e regjimit monist, aq sa nuk u njoh e drejta e veteranit të LANÇ. Libreza e veteranit të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar me nr. 44 të vendimit dhe nr. 6367 të regjistrit themeltar iu dha vetëm pas vdekjes, në vitet e demokracisë më 1995.

Ali Adem Hoxha mësimet e para, shkollën fillore, e kreu në Blliçe më 1951, kurse shkollën 7-vjeçare në Kastriot më 1954. Në vitet 1954-1958 bën studimet e mesme në Medresenë e Tiranës. Më 1958-1959 përfundoi shkollën pedagogjike, në qytetin e Peshkopisë. Në vitet 1959-1963 shërbeu si mësues në shkollën 7-vjeçare në Mamurras dhe në qytetin e sakrifikuar të Laçit në rrethin e Krujës. Në vitet 1963-1967 kreu studimet e larta në Fakultetin e Histori-Filologji, në degën Gjuhë-Letërsi në Universitetin Shtetëror të Tiranës.

Më 1967-1968 kreu kursin për oficer rezervist student pasuniversitar. Më 1968-1970 shërbeu si drejtor i shkollës 8-vjeçare në Grykë Nokë, ku u dallua për shembullin organizativ e rol aktiv në studimin e gjuhësisë popullore e të gjenezës së çidhnakëve. Me kërkesë të tij në vitin 1970 kalon mësues letërsie në shkollën e mesme të Çidhnës, në Fushë-Alie të Dibrës, ku shërbeu me përkushtim e devotshmëri deri në vitin 1982. Më 1981 i hiqet titulli i oficerit rezervist për "kleçka" në biografi. Në periudhën mars-maj 1982 i jepet leje krijuese nga Akademia e Shkencave për kumtesën për Konferenën Kombëtare për etimidologjinë dhe kulturën e popullit shqiptar me temë: "Vështrim historiko-gjuhësor mbi toponominë e trevës së Dibrës".

Në qershor 1982 Ali Hoxha fitoi konkursin për përkthyes nga gjuha shqipe në arabisht në Shtëpinë Botuese "8 Nëntori" të Tiranës. Në gusht 1982 u miratua transferimi nga Peshkopia në Tiranë, por për arsye intrigash e atyre biografike u vonua deri në janar 1983. Për dy vite punon me zell e frytshmëri në sektorin e përkthimit në gjuhën arabe. Me mbylljen e këtij sektori (më 1985) deri më 1992 shërbeu si redaktor në sektorin shkencor të treguesve në Shtëpinë Botuese "8 Nëntori", e cila më pas u emërua "Shtëpia botuese enciklopedike". Pas mbylljes së kësaj shtëpie në periudhën janar–qershor 1993 doli në asistencë nga reforma e vitit 1992. Në qershor 1993 i ndërpreu marrëdhëniet me shtetin e doli në pension të parakohshëm, me 60%, pension të cilin po me 60% e merr edhe tani në vitin 2007 kur ka mbushur plot 67 vjeç.

Pasioni dhe përkushtimi i Ali Adem Hoxhës rrezatoi edhe në pranverën e vitit 1991, ku ishte ndër nismëtarët kryesore në themelimin e gazetës "Drita Islame", organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Si një nga redaktorët e kësaj gazete, Ali Hoxha dha ndihmesë të vyer në udhën e botimeve, në shkrime për botën e shenjtëruar, për paqëtimin njerëzor, për dritën e shpirtit e humanizmin, për traditat e vyera të vllazërimit e të bashkëjetesës në Shqipëri.



Ali Hoxha

Shembulli si organizator në udhën e ndritur të fesë, krahas studimeve me vlera, duhet kur së bashku me 6 shokë të tjerë më 16 tetor 1991, Ali Hoxha rihapi Medresenë e Tiranës në mjediset pranë xhamisë së Kokonozëve, në Pazar të Ri të Tiranës, në të cilën punoi si mësues i letërsisë dhe më pas edhe i gjuhës arabe deri në shtator të vitit 1999. Më 1998-1999 u emërua zv. drejtor i Medresës së Tiranës për anën shkencore, kryesisht për lëndët e shkencave shoqërore dhe të lëndëve fetare. Që nga viti 1992, Ali Hoxha edhe pse me banim në Tiranë u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të KMSH si njëri nga delegatët (përfaqësuesit) e Myftinisë së Dibrës. Në shtator 1993 – qershor 1994 ka kryer specializimin një vjeçar pasuniversitar për gjuhën arabe në Universitetin e shtetit të Kotarit në Doha (kryeqytet i Kotarit). Nga tetori 1996 – janar 1997 ka kryer specializimin pasuniversitar për filozofi dhe teologji islame në Universitetin e Ez'herit në Kajro, kryeqytetin e Egjiptit. Kudo studoi Ali Hoxha u dallua për përgatitje serioze, zell e shembull në përvetësimin e dijeve. Ka dhënë ndihmesë reformuese në Këshillin e Përgjithshëm të Komunitetit Mysliman Shqiptar, në organizimin e strukturave të tij, për statusin, për ndarjen e organit drejtues të legjislatorit nga organi drejtues i ekzekutivit në KMSH.

Në legjislaturën e dytë të KP të KMSH për vitet 1998-2003 Ali Hoxha u zgjodh kryetar i komisionit të arsimit të KP të KMSH, pra njëkohësisht edhe anëtarë i kryesisë së Këshillit të Përgjithshëm të KMSH. Kurdoherë i përkushtuar, studiues pasionant e reformator i guximshëm, Ali hoxha ka dhënë ndihmesë me guximin e njeriut të paqëtimit e të drejtësisë së vërtetë, duke kritikuar hapur e në kohë disa mendime djallëzore të ish-kryesisë së KMSH të viteve 2001-2002, të cilët ndryshuan disa nene të statusit të KMSH, duke e kthyer funksionin e postit të kryetarit të KP të KMSH me rotacion njëvjeçar, me qëllim që kryetari i KP të KMSH të kishte fuqi të kufizuara dhe të mos mund ta kontrollonte në detaje veprimtarinë e ekzekutivit. I hapur dhe i prerë, i matur dhe i patundur në udhën e drejtësisë e të besimit, Haxhi Ali Hoxha ka goditur hapur "puçistët" e veshur me petkun e postin fetar në kryesinë e KMSH.

E çuditshme dhe e lodhshme rruga e Haxhi Ali Hoxhës me seancat gjyqësore për gati 5 vjet, ku me argumente të pamohueshme, me fakte e dokumente kritikon padrejtësitë e puçet në KMSH dhe ende s'ka gjetur zgjidhje. Me synim të drejtën, për mirësinë. Kur e pyetëm se çfarë mendon për këtë z. Haxhi Ali Hxha u përgjigj:

Së pari, falënderoj të madhin Zot për të gjitha të mirat që më ka dhënë, ashtu edhe për vështirësitë me të cilat më ka përballur, sepse gjithë jeta e njeriut është një sprovë në këtë dynja. Ndaj të mirave që zoti më ka dhënë, ne duhet të jemi falënderues ndaj tij, ndërsa me përkallëzimin ndaj vështirësive Zoti na krijon mundësinë që gjithsecili prej nesh të nxjerrë në pah vlerat dhe antivlerat e veta. Se cilat janë vlerat dhe cilat janë antivlerat, njeriu është subjektiv, ai kurrë nuk është në gjendje për të vlerësuar vetveten. Vlerat ose antivlerat e një personi ua përcaktojnë të tjerët e thënë ndryshe i gjykon historia nëse ai ka arritur të lërë ndojë gjurmë që ia vlen historia ta gjykojë atë.

Së dyti, ajo që më ka dhënë forcë dhe rezistencë deri më sot është fakti se unë nuk kam bërë ndonjë gjë të veçantë, por vetëm kam dëshiruar për të vërtetën, ashtu siç na udhëzon All-llahu i Madhëruar në librin e tij të shenjtë në ajetin 135 të sures NISAE të Kur'anit: "O ju që keni besuar (në Zotin Një) të jemi zbatues të ligjit me sinqeritet dhe të dëshmoni të vërtetën për hir të Zotit, qoftë edhe në rast se dëshmia për të vërtetën është kundër interesit tuaj personal (pra, kundër vetvetes), kundër prindërve apo kundër të afërmve tuaj... Të dëshmoni gjithnjë të vërtton pavarësisht se personi ndaj të cilit bëhet mund të jetë i pasur apo i varfër (dmth., ndryshe, vetë ai mund të jetë pushtetar apo qytetar i thjeshtë A.H).

Duke u rikthyer në veprimtarinë e tij shoqërore dhe publicistike, Haxhi Ali Hoxha qysh në vitin 2000 hodhi idenë për të themeluar një shoqatë të pronarëve të pellgut të Drinit të Zi që nga Maqellara e deri në Reç, për të mbrojtur atë nga përmbajtja e mundshme e ndonjë liqeni artificial që mund të ngrihet, sipas një projekti të përfolur me emrin "Hidrocentrali i Skavicës". Atë shoqatë Aliu e themeloi në nëntor të vitit 2002, së bashku me disa shokë të tjerë, të cilët e zgjodhën Aliun president nderi të asaj shoqate. Me argumente bindëse, historike dhe social-ekonomike, në traktatin e tij me titull "Ndal projekteve për shitjen dhe asgjësimin e pellgut të Dibrës" të botuar në gazetën "Rimëkëmbja" në dy numra, me datë 14 qershor dhe 21 qershor 2005 dhe të ribotuar në gazetën "Dibra" të muajt qershor 2005, z. Ali Hoxha ka argumentuar plotësisht se në rast të përmbytjes së Dibrës, dëmi jo vetëm historik, por edhe ekonomik është shumë më i madh sesa fitimi. Lëre që aty nuk bëhet djalë fare për fitim, sepse jo vetëm që Dibra nuk do të ekzistonte fare më, por as vetë hidrocentrali nuk i shërben më kombit, por vetëm xhepave të disa piratëve. Megjithatë, z. Ali Hoxha aty jep dhe alternativën e vet që të jetë me të vërtetë për interesa kombëtare, atëherë qeveritë shqiptare apo kompanitë koncesionare le të ndërtojnë më parë një Dibër të Re, diku në Shqipërinë e Mesme dhe vetëm atëherë mund të hyhet në bisedime me pronarët e vërtetë të Pellgut të Dibrës.

Edhe veprimtaria shkencore e Haxhi Ali Hoxhës është e begatë, tregon vërtet përkushtimin prej studiuesi pensionist e realist, këmbëngulës e të përpiktë. Që nga viti 1971 është bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë të Akademisë së Shencave Tiranë. Nga viti 1974 bashkëpunëtor i jashtëm i Institutit të Historisë Tiranë. Në vitet 1981-1982 ka qenë i zgjedhur nënkryetar i Shoqatës së Gjuhëtarëve të Rrethit të Dibrës. Në vitet 1983-1984 përkthyes në sektorin e arabishtes në Shtëpinë Botuese "8 Nëntori" Tiranë, 1985-1992 redaktor në Shtëpinë Botuese e Enciklopedike. Në vitet 1991-1992 redaktor në gazetën "Drita Islame", në shtator-dhjetor 2003 themelues dhe kryeredaktor i gazetës "Këshilla", organ i Fondacionit të Kur'anit-Tiranë. Punimet e kryera nga Haxhi Ali Hoxha janë mjaft të vlefshme. Studimi shkencor "Mbi lokalizimin e Fushës së Torviollit", ku u zhvillua beteja e parë e Skënderbeut u botua, në "Studime historike", nr. 3 viti 1979 dhe redaktuar në botimin e Akademisë së Shkencave "Studime për epokën e Skënderbeut" (Tiranë 1989, vëllimi II f. 564-572). Studimi "Defteri emëror i Vilajetit të Dibrës" i vitit 1467 botuar në librin "Dibra dhe dibranët" (almanak), nr. 1, viti 1981.

Studimi i "Kryengritja popullore e shtatorit 1913 në Dibër kundër pushtuesve serbë", botuar në gazetën "Ushtima e maleve" 1 nëntor 1981, "Vështirm historiko-gjuhësor mbi toponimet e trevës së Dibrës" (bashkautor, referuar në konferencën kombëtare për formimin e popullit shqiptar Tiranë 1982 dhe botuar në "Studime Filologjike", nr. 3 viti 1982, "Masakra i Çidhnës" e vitit 1466, botuar në "Ushtima e maleve", nëntor 1986, Studimin "Islamizmi" në gazetën "Drita Islame", nr. 5,6,7, viti 1992, "Ndikimi i Kur'anit në kanunin e maleve të Dibrës" (Kumtesë në Prishtinë, më 27 dhjetor 2005).

Për ndihmesën mjaft të çmuar në edukimin arsimor të brezit të ri si mësues dhe për studimet historike dhe gjuhësore të krahinës së Çidhnës në Dibër, komuna e Arrasit në Dibër e ka shpallur Haxhi Ali Hoxhën "Qytetar Nderi", me vendimin e saj të datës 15 prill 2005 me rastin e 65-vjetorit të lindjes. Z. Ali Hoxha në vitet 1992 e 1994 krahas veprimtarisë shkencore shkoi edhe në Mekë në Arabinë Saudite, ndaj mban edhe titullin e lartë Haxhi i punës dhe i besimit të gjuhësisë e të historisë, njeri i paqëtimit dhe i vëllazërimit. Haxhi Ali Hoxha i Çidhnës është veteran i përkushtimit studimor, veterani për shpirtrat e shenjtëruar, njeri i dritës së diturisë, i guximit parimor, njeri i gërmimeve në dobi të brezave dhe të kombit tonë. Cilido që njihet me veprimtarinë e tij si mësues, si studiues, si redaktor e si përkthyes i palodhur, njihet me veteranin e përkushtuar në frontin studimor dhe atë të paqëtimit njerëzor. Urime

Ali Adem Hoxha, veteran i gjurmëve të diturisë e të mirësisë!

Bedri Hoxha, poeti i zërit mërgimtar

Sa herë lexoi krijimtarinë e Bedri Hoxhës nga Deshati i Dibrës, më lind frymëzimi për të shkruar diçka. Ky djalosh i thjeshtë e i përkushtuar letërsisë punon në udhët e vështira të mërgimit. Sapo i ka mbushur 30 vjet. Kur nis e bisedon me Bedriun të duket tamam sikur je në kullat e Deshatit historik, në lëndinat e bukura të Gramës apo në liqenjtë mahnitës të Lurë.Në parathënjen e librit të tretë të këtij mërgimtari studiuesi Llambro Gjikuli thotë:"…ai këmbëngul të jap në vargje këngësh shpirtin e tij, poezinë që e ngacmon dhe e shkruan, i vetmuar në një kthinë ku dhe jeton në emigracion" Bedriu ka lindur në fshatin Deshat. Ka botuar librin e parë me poezi "Qetësi e rikthyer"(maj 1996) "Bota e përbuzjeve" (prozë 2001), cikël me poezi në "Antologjia e poezisë dibrane" si dhe ciklin më të ri tek përmbledhja poetike "Qiejt e shpirtit".Është lakuar shpesh në mediat e shkruara si në Shqipëri ashtu dhe në Greqi

Bedriu është edhe autor i disa këngëve popullore. Sikurse në dy librat e tjerë edhe në librin e tretë "Tinguj që agojnë" poeti Bedri Hoxha shfaq bukurinë e dashurisë njerzore, mallin e madh për atdhe, dialogun me shpirtin, me jetën, me ndjenjat e pastra. Në këtë vëllim poetik të bie në sy simbolika, tonet lirike dhe ngarkesa emocianale. Ja si shprehet poeti mërgimtar:

"Ti erë që fryn
mos vallë vjen prej vendit tim?
Ti këngë që vlon prej buzëve të saj
mos i shkund degët e manit tim?

Malli e zhurit mërgimtarin e Bedriu ka më shumë se dhjet vjet që emigron jashtë atdheut të tij. Tashmë i është përkushtuar edhe këngës. Këndon këngë popullore shqiptare por dhe këngë greke.Në konkursin letrar për poezinë greqisht-shqip u nderua me çmim të parë në Selanik.Ish nxënësi i shkollës së Kastriotit Bedriu krijoi edhe kasetën e dytë me muzikë ballkanike ku dhe ka konkuruar në festivalin Ballkanik të Selanikut me këngën "Mërgimtari".Bedriu është i dhënë edhe pas artit skenik ku ka luajtur në komedinë 'Aristofani" në rolin kryesor Vargjet poetike të Bedri Hoxhës ngjajnë me valët e kaltëra, flladin e lotëve dhe mallin që përvëlon. Poeti shkruan gjithë frymëzim për Olimpin e perëndive, Selanikun e shpresës,mërgimtarin, natën e magjishme,natën që vret Korabin, pranverën e vonuar, amanetet e emigranit,lulen e çelur,qiriun e ndezur, peshën e vuajtjeve në dhe të huaj. Ja si shprehet tek vëllimi "Amanetet e jetës'

"Nëna qan të shkretin djalë
u mbyll dera, u tha hardhia
shkrep rrufeja lart një zjarr
gjëmim tek viset e mia'

apo më poshtë ja si do të shprehet poeti për Korabin

"Retë dhe zotat mblidhen atje
dielli dhe bora ulen atje
maja e tij qëndron mbi rrufe
qiellin e sundon si mbret i lirisë
me emrin e kthjellët të Shqipërisë"

Tek librat e Bedri Hoxhës lexuesi do të gjej mesazhe malli e dashurie, peshën e vuajtjeve në dhe të huaj, krenarinë për vendlindjen. Bedriu edhe pse larg me vargje i këndon bukur vendit të tij të dashur, shpreh mallin për atdheun. Bedriu është poeti i zërit mërgimtar.

MEVLUD BUCI
Drejtor i shkollës Kolë Jakova"

Dibra e Madhe njihet ndryshe dhe si qyteti "i shtatë minareve"

Dibra e Madhe - Kosovë e Vogël dhe Kosova plagë e saj



Nga BEQIR SINA, Nju Jork

DIBER E MADHE : Pas kthimit nga vizita një mujore që i bëra tokës Ilire, u ula të hedh në letër kujtimet e përshtypjet e mija nga ky udhëtim me të vërtet mbresalënës. Mirpo, ato janë aq shumë sa do të më duhet kohë t'i pasqyrojë të gjitha. Megjithatë, çdo gjë do të zerë vendin e saj. Kësaj rradhe mendova vendin t'a le udhëtimit tim në Dibër, jo se jamë edhe vet dibran, por, se sipas përshkrimit të udhëtimeve Dibra e Madhe, është në rradhë. Shoqata Atdhetare Dibrane, me qëndër në Staten Island në Nju Jork, e cila përfaqëson tërë dibranët në SHBA, e ka bërë këtë komun edhe më të njohur këtu në Amerikë.

Ajo nëpërmjet aktiviteteve dhe takimeve të zhvilluar; me zyrtarët dibran nga vendlindja me intelektual, e afaristët dibranë që jetojn e punojnë në Amerikë, ka shërbyer si institucioni i lidhjes. Me rolin e kontributin e dibranve në Amerikë, u bë e mundur që Dibra e Madhe, në vitin 2003 bëri binjakëzim, me ishullin "shtet" Staten Island- Nju Jork. Kështu u realizua vëllazërimi i komunës Dibër e Madhe me qytetin(njërën prej pesë lagjeve me status të veçantë administrativ - Five Borough, të cilat, përbëjnë edhe qytetin e Nju Jork(ut),) e Staten Island në Nju Jork, me qëllim të bashkëpunimit në sfera të ndryshme. Arseyeja kryesore për këtë ishte dhe mundësia e bashkëpunimit të komunitetit dibran që jeton në Staten Island (një numër mbi 9 a -10.000 dibranë), për realizim të qëllimeve me interes të përgjithshëm.

Në këtë aspekt kontribut të vyer kanë dhënë dibranët e Amerikës, banorë në këtë qyetet e rrethinë, të cilët njihen si mjaft të suksesëshëm në bizneset e tyre (ndërtimtari, restorante dhe shit - blerjen e shtëpive). Në këtë mënyrë duke u integruar dhe përfituar nga përvojat amerikane, ata janë të suksesshme në ngritjen e të arriturave ekonomike, sidomos vitet e fundit ata këtë veprimtari ekonomike po përpiqen për t'a shtrirë edhe në komunën e Dibrës së Madhe. Për të joshur dhe afruar sa më shumë dibranët në gurbet, me vend lindjen Dibërn e Madhe, me angazhimet e tyre po dallohet edhe pushteti vendor atje. I cili, ka bërë shumë për nxitjen e biznesmenëve dibranë nga SHBA, dhe Europa, që një pjesë të kapitalit të tyre, dibranët në gurbet t'a angazhojnë për zhvillimin ekonomik të Dibrës së Madhe. Sepse, mendohet se egzistojnë edhe potenciale natyrore e njerëzore. Një fakt që mësova gjatë këtij udhëtimi ishte se vetëm këtë sesion pushimesh e kishin vizituar Dibrën e Madhe, 5.000 familje nga Europa e SHBA-ës. Këtë vit Dibërn e Madhe e kishte vizituar edhe klubi i Futbollit, mjaft të suksshëm në aktivitetet sportive shqiptaro amerikane "Korabi", nga Nju Jorku.

Dibra e Madhe njihet ndryshe dhe si qyteti "i shtatë minareve". Por aktualisht qyteti i Dibrës së Madhe, numëron pesë minare, e gjashta thonë ata është duke u ndërtuar, dhe janë të vendosur të ndërtojnë edhe minaren e shtatë. Qyteti i Dibrës së Madhe është ndërtuar kryesisht nga vetë banorët. Çka e pranojnë dhe vetë zyrtarët e lart të kësaj komune. Aty sheh shtëpi vila, dyqane dhe lokale tregëtie të standarteve më të larta europiane, fryt edhe i ndihmesës së familjve dibrane në gurbet, në Europë e SHBA-ës. Banorët të tregojnë, bie fjala se këtë e ka ndërtuar familja Cami në Amerikë, Marku, Dema, Kolari, Mjeshtri, Papraniku, Erebeli, Pustina, Koleci, Ruci, Peliku, Fida, Shehu, Lita, Maqellara, Kosovrasti, Stercani, Kazani, Uruçi, Rusi, Dovolani, Kercishta, Kllobocishta, Velia, Mirza, Duka, Ballanca e të tjera që është vështirë të permendesh të gjitha .

DIBRA E MADHE

Qytet, qendër e komunës me të njejtin emër në Republikën e Maqedonisë. Shtrihet në bregun e djathtë të Drinit të Zi e të degës së tij Radika, e rrethuar nga veriu prej maleve Velivar (2374 m) e Kërçin (2325 m).Dibra për herë të parë përmendet në hartën e Ptolomeut (shek. II e.r.) me emrin Debrus. Më 1502 njihet si qendër e rëndësishme qytetare. Në vitet 30-40 të shek. XIX, Dibra me afro 8400 banorë dhe 250 dyqane, ishte një nga qendrat më të rëndësishme ekonomike të tregut të mbrendshëm shqiptar. Dibra ka qenë një nga vatrat e qëndresës kundër pushtuesve të ndryshëm dhe dha një ndihmesë të veçantë në luftrat shqiptaro-osmane nën udhëheqen e Skënderbeut. Qyteti dhe rrethet e tij luajtën një rol të rëndësishëm në lëvizjen kombëtare të udhëhequr nga Lidhja Shqipëtare e Prizrenit. Këtu u mbajt edhe Kuvendi i Dibrës (1 Nëntor 1878), që miratoi programin e Lidhjes.

Më 1889 u thirr Kuvendi i Dibrës, ku u vendos bashkimi me lidhjen e Pejës. Me nismën e H. Vokrit më 1900 u hap shkolla e parë shqipe. Dibra dha ndihmesë të shquar në kryengritjen e përgjithshme antiosmane të vitit 1912. Delegatët e saj morën pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës (1912). Vehbi Agolli u zgjodh nënkryetar i qeverisë së parë shqitare që doli nga kuvendi.Popullsia e Dibës u bëri qëndresë të fortë trupave sërbe në vitin 1912 dhe kundërshtoi aneksimin e kësaj krahine nga mbretëria sërbe. Në shtator 1913 u bë qendër kryesore e kryengritjes popullore antisërbe, që u përhap nga Gjakova deri në Ohër.

BUSTI I SKËNDERBEUT DHE HAMAMI

Në qendër të qytetit, është rivendosur busti i heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Afër ndërtesës së komunës ndodhet dhe Hamami, një monument me vlera historiko-monumentale e kulturore, i cili për shkak të pozitës së tij dhe zgjidhjes arkitektonike, nga dibranet është quajtur edhe "bukuroshe e qytetit", që me shekuj u sfidojë të gjitha luftërave shkatrrimtare dhe tërmeteve. Nga takimi që pata me këtë rast, zhvilluar në zyrën e komunës me kryetarin të Dibrës, z Argëtim Fida, mësova se sapo ka përfunduar faza e parë e rikonstruimit të Hamamit të ri, në mesin e qytetit, merametimi dhe përforcimi i kulmit dhe të kupolave me foli bakri.

Për fazën e parë, tha ai janë shpenzuar 100 mijë euro. Ndërkaq, faza e dytë parasheh rikonstruimin e shadërvanit dhe aneksit të banjës. me mjete këto të siguruara nga Banka ekonomike për rikonstruim dhe Ministria e Kulturës, në këtë aktivitet do të përfshihet edhe pushteti vendor.

KOMUNA DIBRA E MADHE - KRYETARI I SAJ DR.ARGËTIM FIDA

Kjo komunë ka rreth dy vite që ka për kryetar komune dr Argëtim Fidën, nga Partia Bashkimi Demokratik për Integrim e Ali Ahmetit. Fida, konsiderohet si një ndër nga më të suksesëshimit kryekonunarët e Dibrës së Madhe.Kryetari i komunës me një mandat katër vjeçarë situatën politike e quan të brishtë, atë ekonomike dhe me strategjinë zhvillimore të komunës së Dibrës, si shumë optimiste, dhe me prespektivë duke theksuar: "Së bashku me dëshirën tonë për t'u integruar në BE duhet ta instalojmë edhe mentalitetin evropian në komunë, në drejtim të mendimit e menaxhimit" thotë ai.

Argëtim Fida, kryetar i zgjedhur me mandat katërvjeçar, thotë se e ka gjetur arkën e komunës me një saldo negative, që kapte një borxh prej 1,2 milionë euro, kurse me këtë ka trashëguar edhe xhirollogarinë e bllokuar drejt hapjes së perspektivave. Dr Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës, vlerson lart lidhjet e tyre me -prefekturën e Qarkut të Peshkopisë - Dibër e Vogël. Fida, duke folur për qëllimin e këtyre lidhjeve, thotë se shumë probleme që kanë të bëjnë me Dibrën në dy anët e kufirit të saj janë zgjidhur ose



Ndahet nga jeta një nga personalitetet e njohura të kinemasë shqiptare

Shuhet regjisori dibran Gëzim Erëbara

Regjisori, i cili kërkonte të sillte diç ka ndryshe gjatë çdo prodhimi kinematografik, që mbante poshtë firmën e tij, Gëzim Erebara është ndarë nga jeta në moshën 78-vjeçare. Njohësi i mirë i artit të shtatë dhe një nga kontribuuesit më të njohur të këtij arti, njeriu i publicistikës dhe i mendimeve të ndryshme letrare iku përgjithmonë nga kjo fushë, të cilën e deshi aq shumë. Erebara do të kujtohet jo vetëm për mënyrën se si operoi në një kohë jo të lehtë për të bërë art, por dhe për konceptet që përcolli nëpërmjet filmave që mbajnë emrin e tij. I qetë dhe gjithnjë i gatshëm për të treguar se arti ngrihet vetëm mbi të vërtetën, njeriu që kontribuoi aq shumë për kinemanë tashmë do t'i mungojë jo vetëm familjes, por edhe kinemasë. Gëzim Erebara u lind në vitin 1929 në Dibër. Mbasi mbaron studimet e mesme, në vitin 1948 shkon për studime ne Çeki, ku studion për regjisor, por që për fat të keq nuk i mbaroi studimet e tij. Në vitin 1957 fillon punë në kinostudion "Shqipëria e re" si regjisor e skenarist. Për rreth 30 vjet punoi në kinostudio, duke realizuar disa filma artistikë dhe dokumentarë, në disa prej tyre është edhe skenarist njëkohësisht.

Pas një përvoje si asistent regjisor në filmat "Tana", "Furtuna" dhe "Debatik", realizon më në fund filmin e tij të parë në vitin 1967 "Ngadhënjim mbi vdekjen" (së bashku me regjisorin Piro Milkani). Më pas realizon edhe dhjetë filma të tjerë, ku filmi i tij i fundit i përket vitit 1986 "Një jetë më shumë".

Në filmat e tij me të mirë përmendim "Në fillim të verës", fitues i disa çmimeve në festivalin e filmit, "Vajzat me kordele të kuqe", "Një natë pa dritë", "Pylli i lirisë", "Fushë e blertë-fushë e kuqe" etj. Karakteristika të filmave të rinj janë thjeshtësia e paraqitjes së subjektit, karakteri popullor dhe vërtetësia e pasqyrimit jetësor. Kino-regjisori Gëzim Erebara është edhe autori i mjaft filmave dokumentarë. Le të përmendim filmat "Migjeni" (1961),"Gjirokastra" (1962), "Vangjush Mio" (1965), "Ndre Mjeda" (1962), "Ata quheshin Arbër" (1973) etj. Në punën e tij si dokumentarist i pasionuar, Gëzim Erabarën e karakterizon qartësia e brendshme ideore; ai është i vetëdijshëm se, kur ideja është e freskët, e ndjerë, teknika vjen vetë.

Gëzim Erebara ka dhënë një kontribut të veçantë në fushën e publicistikës. Ai ka botuar me dhjetëra artikuj në organet e shtypit, ku ka dhënë mendimin e tij profesional, duke bërë kritikën dhe njëkohësisht analiza për vepra të veçanta. Gëzim Erebara është vlerësuar me disa çmime, si dhe mban titullin "Artist i Merituar". Ai mbetet njëri prej regjisorëve tanë më të mirë të filmit shqiptar.



Gëzim Erebara është vlerësuar me disa çmime, si dhe mban titullin "Artist i Merituar". Ai mbetet njëri prej regjisorëve tanë më të mirë të filmit shqiptar.

FILMA ARTISTIKË:
1967: "Ngadhënjim mbi vdekjen"
1970: "Guximtarët"
1975: "Në fillim të verës"
1976: "Pylli i lirisë"
1978: "Vajzat me kordele të kuqe"
1979: "Përtej mureve të gurta"
1980: "Nusja"
1981: "Një natë pa dritë"
1984: "Fushë e blertë-fushë e kuqe"
1986: "Një jetë më shumë" etj.

DOKUMENTARË:
"Migjeni" (1961)
"Gjirokastra" (1962)
"Vangjush Mio" (1965)
"Ndre Mjeda" (1962)
"Ata quheshin Arbër" (1973) etj.

Në sheshin e xhirimit të filmit "Guximtarët", 1970.

Dibra e Madhe - Kosovë e Vogël dhe Kosova plagë e saj

presin të zgjidhen. Ai flet për mundësin reale për punësim dhe prespektivat e të rinjëve dibranë për përkrahjen e tyre edhe nga shoqatat joqeveritare, siodomos vlerson takimin e mbajtur mbi bazën e Projektit për punësimin e të rinjve me arsim të lartë. Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës, shprehu keqardhjen e tij " për peshkimin ilegal të peshqve në liqenin e Dibrës, në këtë liqen vijnë me vetura persona të veshur edhe me pushtet, duke vjedhur edhe pasurinë më të çmuar të këtij liqeni," tha ai.

Ai tha se kan filluar punimet në rregullimin e trotuareve. Një pjesë e qendrës së qytetit është shëndruar në punishte të mirëfilltë infrastrukturore. Në saje të angazhimit intenziv të tij komuna e Dibrës tashmë ka miratuar projektin për shtruarjen edhe të 3000 metra katrorë trotuare me pllaka betoni, që kap vlerën prej 80 mijë eurosh. Fida, pohon se: "Potencialet natyrore e njerëzore presin investime Komuna e Dibrës ka ekonomi të alivanosur që karakterizohet me afër 5000 të papunë, mes tyre 120 persona me përgaditje shkollore të lartë dhe universitare dhe ka përpara një sfidë të madhe sa i takon ëmbëlsimit të kësaj situate jetike për banorët." Brengosës është numri i vogël i policëve, posacërisht të atyre vendas, sepse aktualisht pjesa më e madhe e policëve që e ruajnë kufirin janë nga Maqedonin lindore, të cilët nuk e njohin as gjuhën shqipe dhe as njerëzit që kanë pronat e tyre përreth kufirit . Në fund Fida, foli edhe për vizitën dhjetëditore që bëri vitin e kaluar në SHBA. Për pritjen e ngroht të komunitetit dibran dhe Vatrës.



Tek Shtatorja e Skënderbeut

MIRËQENEJA


Statistikat tregojnë se disa për qind e popullsisë janë në asistencë. Përkrahja sociale është jo shumë e mjaftueshme. Banorët paguajnë një taksë për shtëpinë, të cilën e mbledh ndërmarrja komunale. Taksat e tjera kalojnë direkt e në buxhetin e shtetit. Shumë prej ndërmarrjeve të para '90-ës janë mbyllur ose aktiviteti i tyre është përgjysmuar. Ndërmarrja e plastikës është mbyllur, po kështu dhe fabrika e qilimave. E vetmja ndërmarrje që punon me kapacitet të plotë është ajo e gipsit, e privatizuar nga një firmë gjermane. Familjet, jo të gjitha thuhet se mbahen me të ardhurat e dibraneve gurbetqarë Punimi artizanal është ende i zhvilluar. Disa familje jetojnë dhe me të ardhurat e siguruara nga tregtia . Aktivitet kulturore e sportive kan filluar të ringjallen. Qyteti ka një shkollë 8-vjeçare dhe një gjimnaz, ku mësojnë si shqiptarët dhe sllavët apo pakicat e tjera, si ato turke, ka një siptal, ambulanc, ka një skuadër Futbolli dhe kajaku. Ka një grup muzikor me kino-teatër. Ka diskotek, dhe parqe e fusha natyrore sportive.

RRUGA E ARBËRIT

Bëhet fjalë për një ndër rrugët më të vjetra në Shqipëri, rrugën e vjetër, e cila kalon nga Tirana e të çon përmes Qafës së Priskës në Klos dhe më pas në Dibër të Madhe e më tej. Rruga e vjetër e Dibrës është e gjatë vetëm 67 kilometra, ndërkohë që rruga ekzistuese është e gjatë 160 kilometra. Ajo vazhdon të mbetet edhe sot, si një rrugë këmbësorësh. Në vitin 1994, ish-kryeministri Aleksandër Meksi hodhi hapin e parë zyrtar për ekzaminimin e mundësive për ndërtimin e kësaj rruge. Njërëz të interesuar kan kërkuar gjithashtu nga qeveria studimin e përfitimeve që mund të vijnë nga ndërtimi i kësaj rruge. Rruga e vjetër e Dibrës është njohur shpesh si "Rruga e Arbërit". Rëndësia e saj strategjike, gjeopolitike dhe ekonomike vlerësohet ekspert e specilast si dhe nga qeveria aktuale, por praktikisht asnjë hap konkret për ndërtimin e saj nuk ka deri tash, përveç hartimit të studimit të fizibilitetit nga qeveria shqiptare si dhe miratimit të gjurmës së saj nga Këshilli Kombëtar i Rrugëve në Tiranë. Në rast se kjo rrugë do të ndërtohej, segmenti Tiranë - Dibër mund të përshkohet në më pak se dy orë. "Rruga e Arbërit" mendohet se është gjithashtu mundësia më e lirë për t'u lidhur me Kosovën, duke kaluar tranzit në republikën e Maqedonisë.

B.Sina

BOTIME TË AUTORËVE DIBRANË



NJË FJALOR I RI PËR GJUHËN SHQIPE

Nga Prof. Dr. ENVER HYSA

Leksikografia shqipe, fusha që merret me hartimin e fjalorëve, ka një traditë të gjatë e të pasur. Që nga viti 1635, kur u botua *Fjalori latinisht – shqip (Dictionarium latino-epirotikum)* i Frang Bardhit, e deri në ditët e sotme janë hartuar e botuar rreth 500 fjalorë dy e më shumë gjuhësh dhe fjalorë shpjegues, çka përbën një pasuri të paçmuar që vjen e rritet kohë pas kohe. Fjalorët shpjegues të shqipes, duke veçuar Fjalorin e K. Kristoforidhit, janë hartuar e botuar duke filluar nga gjysma e dytë e shekullit XX dhe këtë 10-vjetshin e parë të këtij shekulli.

Vepra *Fjalor i gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006 është një realizim i ri i gjuhësisë shqiptare, një vepër e re e leksikografisë shqiptare, që del si botim i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe përbën një realizim të ri të njërit nga projektet e rëndësishme të këtij Instituti. Vepra i shtohet fondit të pasur të fjalorëve të shqipes. Për nga natyra e ndërtimit dhe për nga tipologjia e fjalorëve, ky botim i ri do të zërë padyshim një vend të veçantë e të rëndësishëm në këtë fond të pasur të leksikografisë shqiptare.

Është e ditur se një fjalor me një sasi të tillë fjalësh (mbi 43 mijë, si fjalë themelore në krye e në çerdhe, si dhe me rreth 5 mijë fjalë të tjera që përdoruesit mund t'i rindërtojnë vetë duke shfrytëzuar shkurtesat e dhëna në *Fjalor*, sipas modeleve të njohura*)* përmban padyshim shtresën aktive, por edhe një pjesë të mirë nga shtresa pasive, e cila zë një vend të gjerë në përdorimin e përditshëm, në letërsi, në shtypin e shkruar dhe elektronik, në letërsinë tekniko-shkencore etj., prandaj edhe në këtë tip fjalori del si e domosdoshme prania e këtij leksiku, qoftë dhe nëpër fjalorë të ashtuquajtur të vegjël, por me një numër të konsiderueshëm fjalësh. Natyrisht që tipi i *Fjalorit*, i cili këto ditët e fundit ka dalë nga shtypi, nuk mund të ketë shumicën e fjalëve që ka shqipja ose gjithë pasurinë leksikore të saj, siç mëtohet ndonjëherë nga disa përdorues, të cilët nisen nga dëshira e mirë për ta parë atë të përfshirë të gjithën në një fjalor. Është e domosdoshme të njihet nga afër specifika e hartimit të fjalorëve dhe sidomos tipat e tyre dhe në përputhje me natyrën e fjalorit të shprehen dhe kërkesat e dëshirat për një pasuri më të madhe që mund të përfshinte ky ose ai fjalor. Fjalorët e mëdhenj të një gjuhe të caktuar e kanë për detyrë të regjistrojnë çdo fjalë dhe kuptimet e shumta që mbart ajo, pra gjithë visarin e shqipes. Hartimi i një fjalori të madh të gjuhës shqipe, ku do të përfshihej gjithë pasuria leksikore e saj mbetet një nga objektivat për projektet e ardhshme të gjuhësisë shqiptare.

Kjo vepër e re leksikografike është ndërtuar mbi kritere të drejta e të sakta shkencore dhe është në hullinë e botimeve më të mira të leksikografisë sonë, sidomos asaj që i përket gjysmës së dytë të shek. XX e në vijim, duke nisur me fjalorët shpjegues të viteve 1954, 1980, 1984 e 2002. Vepra përshkohet nga synimi për t'i dhënë më shumë hapësirë një numri sa më të madh fjalësh në përputhje me tipin e tij dhe është ndërtuar mbi kritere që e mundësojnë realisht këtë synim.

Lënda e këtij Fjalori sigurisht që mbështetet dhe në lëndën e fjalorëve të mëparshëm, në fondin e pasur që gjendet në kartotekën e leksikut të shqipes të Institutit të Gjuhësisë dhe të letërsisë, e cila përmban sot rreth 4 milionë skeda për fjalë, shprehje e frazeologji të vjela nga fjalorë të shqipes, nga folklori, nga botime të llojeve të ndryshme, si dhe të mbledhura nga të folme e dialekte të truallit të shqipes nëpërmjet ekspeditave gjuhësore dhe nga shumë bashkëpunëtorë të jashtëm të Institutit. Por ajo mbështetet edhe në lëndën që vjen nga botimet e këtyre 10-15 viteve të fundit (letërsi, shtypi i ditës, fjalorë krahinorë, fjalorë dygjuhësh etj.). Ky korpus i pasur, natyrisht i përzgjedhur, bën që ky Fjalor, ashtu siç thuhet në parathënie, jo vetëm të ruajë vlerat themelore më të mira të fjalorëve shpjegues të deritanishëm të shqipes, por edhe t'i shtojë ato, si nëpërmjet dhënies së një lënde të re (p.sh., vetëm shkronja *A* ka afërsisht mbi 100 njësi të reja leksikore, si zëra të veçantë leksikografikë, më shumë se fjalorët e mëparshëm), po ashtu dhe nëpërmjet trajtimit në një mënyrë më sintetike e në mjaft raste me çerdhe fjalësh, si një zgjidhje e zbatuar ndoshta për herë të parë në praktikën tonë leksikografike. Të gjitha këto, si dhe një varg përparësish të tjera, të cilat zbulohen qartë në kriteret e hartimit dhe në realizimin konkret në vepër, e bëjnë këtë *Fjalor* të ri një mjet pune praktik e të përdorshëm me lehtësi, gjë që, duke e vështruar në këtë aspekt, mund të thuhet se një fjalor, si një vepër e tillë, i ka munguar praktikës që nga viti 1954, kur u botua i pari fjalor shpjegues i gjuhës shqipe.

Për vlerat e *Fjalorit* mund të flitej gjatë, por do të jenë përdoruesit ato që do të thonë fjalën e tyre si për vlerat e vërteta të tij, ashtu edhe për ndonjë të metë që mund të vënë re, duke e shfletuar atë për nevojat e tyre. Megjithatë mund të theksohet se është vepruar drejt që, në përputhje me parimet e hartimit të veprës, duke synuar për një paraqitje sa më të ngjeshur të zërave leksikografikë, janë përfshirë në një të tillë, sipas sistemit të çerdheve, p.sh., foljet veprore, vetvetore, emrat e veprimit, mbiemrat prejpjesorë, emërzimet e tyre, të cilët, siç thuhet, kanë forma e struktura kuptimore thelbësisht të njëjta. Kjo praktikë leksikografike, e njohur gjerësisht edhe për gjuhë të tjera, është një zgjidhje e drejtë e praktike leksikografike. Kështu, p.sh., te folja *lexoj* përdoruesit do të gjejnë edhe emrin *lexim* edhe formën joveprore *lexohet*, ose te folja *lë*, si fjalë titull, dalin edhe pësorja e kësaj foljeje *lihem,* edhe emri *lënie,* edhe mbiemri *i lënë,* edhe emri *të lënat* në kuptimin "*mbeturinat e gjellëve, të bukës*, te folja titull *kontrolloj,* del dhe forma *kontrollohem,* edhe emri *kontrollim,* edhe mbiemri *i kontrolluar* ose te folja *korr* del emri *korrje,* forma joveprore *korret,* mbiemri *i korrur* dhe emri *të korrat* etj.". Në këtë mënyrë në vend të 3, 4 ose 5 fjalëve të veçanta që jepen nëpër fjalorë të tjerë, këtu të gjitha ato fjalët dhe format e tyre që lidhen jo vetëm nga forma, por edhe nga kuptimi, paraqiten vetëm te një fjalë titull. Ky sistem paraqitjeje mund të shtrihej e të zgjerohej dhe më tej duke përfshirë edhe mbiemrat e emrat e formuar nga pjesorja e gegërishtes me prapashtesat *–s, -shëm,* të cilët edhe nga pikëpamja kuptimore dhe nga pikëpamja fjalëformuese, nuk janë aq të largëta nga çerdhja. Ndërkaq, në këtë mënyrë paraqitjeje fjalësi nuk pakësohet, siç mund të duket në vështrimin e parë, sepse në të vërtetë fjalët janë aty, por në një farë mënyre të fshehura dhe përdoruesi, pasi të mësohet me paraqitjen sistematike të çerdhes së fjalëve, nuk do të ketë vështirësi në identifikimin e njësive që dëshiron të konsultojë.

Fjalët në fjalor janë shoqëruar rregullisht me shpjegime të thjeshta, jo të rënduara e përgjithësisht sintetike, në mjaft raste janë dhënë sinonime, qoftë një i vetëm ose më shumë se një, ka dhe mjaft raste kur në paraqitjen e kuptimit të një fjale, krahas shpjegimit, jepet dhe sinonimi ose sinonimet, janë përdorur pra, shpjegimet, shpjegimet dhe sinonimet ose vetëm sinonimet. Kjo është ndjekur në mënyrë sistematike në fjalor. Kështu, p.sh., për fjalën *përbri*, si ndajfolje jepet në fillim shpjegimi "*në afërsi ose në krah (të dikujt a të diçkaje)*", pastaj jepen sinonimet "*përkrah, pranë; anash*", më pas jepen shembuj të përdorimit si ndajfolje; *në dhomën këtu përbri, më kaloi përbri.* Po te kjo fjalë do të gjendet dhe përdorimi i saj si parafjalë, duke dhënë fillimisht shpjegimin: *së bashku me një emër a me një përemër shënon frymorin ose sendin, afër të cilit lëviz dikush a diçka*, pastaj jepen sinonimet: *pranë, anës* dhe më pas shembujt: *ecte përbri shokut, ndodhej përbri fabrikës.* Kjo strukturë ndiqet rregullisht në paraqitjen e të gjitha fjalëve të fjalorit. Po ndërkaq në mjaft raste fjalët jepen dhe në përdorimin e tyre në shprehje të ndryshme frazeologjike, të cilat janë zgjedhur me kujdes nga hartuesit e fjalorit. Në këtë mënyrë, sa për të dhënë ndonjë shembull, po kujtoj për lexuesit e gazetës se fjala *liri* jepet dhe në shprehjen frazeologjike "*i ka dhënë liri gjuhës*" në kuptimin "*flet shumë e pa u menduar mirë, nuk i vë fre gjuhës*", ose te fjala *lis* dalin njësitë frazeologjike "*është lis me shumë degë (është njeri i zoti e me shumë shokë e miq, ka përkrahje të madhe), qysh kur ka mbirë lisi (prej shumë kohësh, qyshkur), prish tre lisa për një purtekë (e bën një punë me shumë harxhime, prish bucela e bën kënaçe) unë për lisa ti për fshesa (nuk kuptohemi fare me njëri-tjetrin)* etj. Mund të pohojmë pra se përgjithësisht shpjegimet e dhëna janë të qarta, të shkurtra e të kursyera, shembujt dhe frazeologjia që shoqërojnë jetën e fjalës janë dhënë gjithashtu me masë. Të gjitha këto e bëjnë këtë fjalor një mjet të domosdoshëm të një përdorimi të gjerë e masiv që do të ndihmojë në ngritjen e kulturës gjuhësore të përdoruesve të tij.

Në përfundim dëshiroj të theksoj se kjo vepër e re e gjuhësisë shqiptare është hartuar nga ekipi i njohur i leksikografëve prof. Jani Thomai, prof. Miço Samara, prof. Pavli Haxhillazi, prof. Hajri Shehu, prof. Thanas Feka, prof. Valter Memishaj e dr. A. Goga, të cilët kanë realizuar një vepër të nevojshme për bibliotekat vetjake, për bibliotekat e shkollave të të gjitha niveleve e për të gjitha hapësirat shqiptare. Ata duhen përgëzuar e falënderuar që arritën t'i japin gjuhësisë shqiptare një vepër të tillë, të realizuar me një cilësi shkencore të lartë, me zgjidhje të reja për praktikën tonë leksikografike, me materiale e lëndë të pasur për tipin që ka fjalori dhe me një sasi njësish të reja që përfshihen për së pari në këtë fjalor. Edhe nga realizimi teknik dhe vëllimi fjalori paraqitet mjaft praktik në përdorim Të gjitha këto i sigurojnë këtij fjalori një numër të gjerë përdoruesish, si nxënës të shkollave të mesme e nëntëvjeçare, studentë, mësues e pedagogë, shkrimtarë, përkthyes, gazetarë etj.

FTESË PËR BASHKËPUNIM

Gazeta "Rruga e Arbërit" është e hapur për çdo lloj bashkëpunimi.
Të Interesuarit mund të sjellin opinionet e tyre për çeshtje e probleme të ndryshme që shqetësojnë Dibrën e dibranët.
Redaksia mbetet e hapur për çdo lloj bashkëpunimi, me synimin e vetëm: përhapjen e së vërtetës dhe mendimit progresist.
Redaksia kujton bashkëpunëtorët se dorëshkrimet janë të pakthyeshme dhe jo çdo shkrim mund të botohet.
Tel.068 31 19 232. Tel: (04) 357 179. Email: lid_gazeta@yahoo.com

*Grafika: **Studio "m&b"**. Tel: (04) **233 283**. Shtypur në shtypshkronjën "**Dita 2000**". Tel: (04) **273 745***